FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 111

Tiranë – E martë, 30 qershor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 59/2015 datë 11.6.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.....	5897
Ligj nr. 60/2015 datë 11.6.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për paradhënie për përgatitjen e projektit të propozuar "Shërbime publike me në qendër qytetarin".....	5902
Ligj nr. 61/2015 datë 11.6.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (Cosme) 2014-2020".....	5908
Ligj nr. 62/2015 datë 11.6.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.....	5916
Ligj nr. 63/2015 datë 11.6.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri.....	5918
Ligj nr. 64/2015 datë 11.6.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin suedez të besimit, për Fondin e Besimit nr. Tf072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë.....	5926

LIGJ
Nr. 59/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9143, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, më poshtë të quajtura "Palët",

duke njohur nevojën e të dyja Palëve për të garantuar mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet tyre në kuadrin e bisedimeve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ose që do të lidhen ndërmjet subjekteve publike dhe private të Palëve;

me dëshirën për të vendosur një sërë rregullash për mbrojtjen reciproke të Informacionit të Klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet Palëve,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti

Kjo Marrëveshje vendos rregullat e sigurisë, të zbatueshme për të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit, të cilat parashikojnë transmetimin e Informacionit të Klasifikuar, të nënshkruar ose që do të nënshkruhet ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve ose nga subjektet e autorizuara rregullisht për këtë qëllim.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo Marrëveshje përcakton procedurat për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të gjeneruar ose të shkëmbyer ndërmjet Palëve.

2. Asnjë Palë nuk i referohet kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të marrë Informacion të Klasifikuar që Pala tjetër ka marrë nga një Palë e Tretë.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Kontratë e klasifikuar" është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Kontraktuesve që krijojnë ose përcaktojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre që përmbajnë ose përfshijnë Informacion të Klasifikuar;

2. "Informacion i Klasifikuar" është çdo informacion ose material i përcaktuar për të kërkuar mbrojtje ndaj deklarimit të paautorizuar, i cili është përcaktuar i tillë nga një klasifikim sigurie;

3. "Kontraktues" është një person fizik ose juridik që ka zotësinë juridike për të lidhur Kontrata të Klasifikuara;

4. "Autoritet Kompetent Sigurie" është autoriteti i përcaktuar nga një Palë, si përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kësaj Marrëveshjeje;

5. "Certifikatë Sigurie Industriale" është përcaktimi nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë që, nga këndvështrimi i sigurisë, një strukturë ka zotësinë fizike dhe organizative për të përdorur dhe për të depozituar Informacionin e Klasifikuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme;

6. "Nevoja për të ditur" do të thotë që aksesi në Informacionin e Klasifikuar mund t'i jepet vetëm një personi i cili ka një kërkesë të verifikuar për njohjen ose për zotërimin e këtij informacioni, me qëllim që të përmbushë detyrat e tij zyrtare dhe profesionale.

7. "Pala e Origjinës" është Pala që ka prodhuar Informacionin e Klasifikuar ose që ia transmeton Palës tjetër;

8. "Certifikatë Sigurie Personeli" është përcaktimi nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë që një individ është i pranueshëm për të pasur akses në Informacion të Klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme;

9. "Pala Marrëse" është Pala që merr Informacionin e Klasifikuar të prodhuar ose të transmetuar nga Pala e Origjinës;

10. "Palë e Tretë" është një organizatë shtetërore ose ndërkombëtare, e cila nuk është Palë në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Autoritetet kompetente të sigurisë

1. Autoritetet Kompetente të Sigurisë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare).

Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës:

Sekretari i Shtetit, Drejtori i Qendrës Kombëtare të Inteligjencës, Zyra Kombëtare e Sigurisë.

2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për çdo ndryshim në lidhje me Autoritetet Kompetente të Sigurisë.

Neni 5

Klasifikimet dhe barasvlershmëritë e sigurisë

1. Palët i japin Informacionit të Klasifikuar të transmetuar, të prodhuar ose të zhvilluar në të njëjtën shkallë mbrojtjeje sigurie, si ajo që është parashikuar për Informacionin e tyre të Klasifikuar, në nivel të barasvlershëm.

2. Pala e Origjinës njofton Palën Marrëse në lidhje me çdo ndryshim të kryer në shënjimin e Klasifikimit të Sigurisë të Informacionit të transmetuar.

3. Pala Marrëse nuk ul nivelin dhe as deklasifikon ndonjë Informacion të Klasifikuar të marrë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës.

Niveli i Klasifikimit të sigurisë, që i jepet informacionit të gjeneruar në procesin e bashkëpunimit reciprok të Palëve përcaktohet, modifikohet ose deklasifikohet vetëm me pëlqim të ndërsjellë. Në rastin e mosrënies dakord për nivelin e klasifikimit të sigurisë që i jepet këtij informacioni, Palët miratojnë nivelin më të lartë të propozuar nga njëra prej tyre.

4. Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigurisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

SHQIPËRI	**SPANJË**
TEPËR SEKRET	SECRETO
SEKRET	RESERVADO
KONFIDENCIAL	CONFIDENCIAL
I KUFIZUAR	DIFUSIÓN LIMITADA

Neni 6

Parimet e sigurisë

1. Mbrojtja dhe përdorimi i Informacionit të Klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet Palëve përcaktohet nga parimet e mëposhtme:

a) Aksesi në Informacionin e Klasifikuar KONFIDENCIAL/ CONFIDENCIAL ose më lart është i kufizuar për personat që kanë nevojë për të ditur, me qëllim që të përmbushin funksionet e tyre, të cilat janë autorizuar nga autoritetet përkatëse dhe u është dhënë Certifikatë Sigurie Personeli për nivelin përkatës. Në rastin e aksesit në Informacionin e Klasifikuar të nivelit I KUFIZUAR/DIFUSIÓN LIMITADA, ai kufizohet për individët që kanë nevojë për të ditur dhe janë të autorizuar dhe të udhëzuar rregullisht;

b) Pala Marrëse nuk ia transmeton Informacionin e Klasifikuar asnjë Pale të Tretë apo individi, apo subjekti që nuk ka shtetësinë e njërës prej Palëve në këtë Marrëveshje, pa autorizimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës;

c) Informacioni i Klasifikuar nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveç atij për të cilin është transmetuar bazuar në këtë Marrëveshje dhe çdo marrëveshje tjetër bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet Palëve.

2. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standardet e krahasueshme të sigurisë, Autoritetet Kompetente përkatëse të Sigurisë, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikat e sigurisë për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

3. Secila Palë garanton që të gjitha subjektet që kanë marrë Informacionin e Klasifikuar nga Pala tjetër, të respektojnë rregullisht detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

Neni 7
Ndihma për certifikatat e sigurisë

1. Autoritetet Kompetente të Sigurisë së Palëve, duke marrë parasysh ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, me kërkesë, ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë procedurave të lejeve të qytetarëve të tyre, të cilët banojnë dhe gjenden në territorin e një Pale.

2. Palët njohin Certifikatat e Sigurisë të Personelit dhe Industriale, të lëshuara në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të Palës tjetër.

3. Autoritetet Kompetente të Sigurisë informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim që mund të ndodhë në lidhje me një Certifikatë Sigurie Personeli ose Industriale, veçanërisht në lidhje me çështjet e tërheqjes ose të uljes së nivelit të tyre të klasifikimit.

Neni 8
Përkthimi, riprodhimi dhe asgjësimi

1. Informacioni i Klasifikuar në nivelin TEPËR SEKRET/SECRETO përkthehet ose riprodhohet vetëm me leje paraprake me shkrim të Autoritetit Kompetent të Palës së Origjinës.

2. Përkthimet dhe riprodhimet e Informacionit të Klasifikuar kryhen në pajtim me procedurat e mëposhtme:

a) Individët përgjegjës për përkthimin ose për riprodhimin e Informacionit të Klasifikuar kanë Certifikatë të Përshtatshme të Sigurisë të Personelit, sipas rastit;

b) Përkthimet dhe riprodhimet shënjohen me shenjën origjinale të klasifikimit dhe vendosen nën të njëjtën mbrojte, si dhe origjinalet;

c) Përkthimet dhe riprodhimet kufizohen në numrin e kërkuar për qëllime zyrtare;

d) Përkthimet kanë një shenjë të përshtatshme në gjuhët në të cilat ato bëhen, duke treguar që ato përmbajnë Informacion të Klasifikuar të marrë nga Pala e Origjinës.

3. Informacioni i Klasifikuar deri në nivelin SEKRET/RESERVADO asgjësohet në mënyrë të tillë që të jetë e pamundur rimbledhja e pjesëve, pjesërisht ose plotësisht, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme.

4. Informacioni i Klasifikuar në nivelin TEPËR SEKRET/SECRETO nuk asgjësohet dhe i kthehet Autoritetit Kompetent të Palës së Origjinës.

Neni 9
Transmetimi ndërmjet palëve

1. Informacioni i Klasifikuar transmetohet normalisht ndërmjet Palëve me anë të kanaleve diplomatike. Mjetet e tjera të aprovuara të transmetimit të Informacionit të Klasifikuar mund të përdoren nëse bihet dakord nga Autoritetet Kompetente të Sigurisë.

2. Nëse përdorimi i këtyre kanaleve do të ishte jopraktik ose do të vononte pa shkak marrjen e Informacionit të Klasifikuar, transmetimet mund të ndërmerren nga personeli me Certifikatë të Përshtatshme Sigurie Personeli, në zotërim të një certifikate korrieri të lëshuar nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës që transmeton Informacionin e Klasifikuar.

3. Palët mund të transmetojnë Informacion të Klasifikuar me mjete elektronike në pajtim me procedurat e sigurisë të aprovuara reciprokisht nga Autoritetet Kompetente të Sigurisë së Palëve.

4. Shpërndarja e artikujve që përmbajnë sasi të mëdha të Informacionit të Klasifikuar, të rregulluar në bazë të parimit rast pas rasti, aprovohet nga të dyja Autoritetet Kompetente të Sigurisë.

5. Pala Marrëse konfirmon marrjen e Informacionit të Klasifikuar të Palës së Origjinës.

Neni 10
Masat industriale të sigurisë

1. Para dhënies së Informacionit të Klasifikuar në lidhje me një Kontratë të Klasifikuar Kontraktuesve, nënkontraktuesve apo kontrak-

tuesve të mundshëm, Pala Marrëse njofton Palën e Origjinës, nëse:

a) strukturat e tyre kanë zotësinë të mbrojnë Informacionin e Klasifikuar;

b) ata kanë Certifikatë Sigurie Industriale për trajtimin e Informacionit të Klasifikuar në nivelin e përshtatshëm;

c) personeli i tyre është në zotërim të nivelit të duhur të Certifikatës së Sigurisë të Personelit, për të përmbushur funksionet që kërkojnë akses në Informacionin e Klasifikuar;

d) të gjithë individët që kanë akses në Informacionin e Klasifikuar informohen për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të Palës Marrëse.

2. Çdo Autoritet i Sigurisë Kombëtare, mund të kërkojë që të kryhet një inspektim i sigurisë në një strukturë, për të garantuar respektimin e vazhdueshëm të standardeve të sigurisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare.

3. Një Kontratë e Klasifikuar përmban dispozita mbi kërkesat e sigurisë dhe klasifikimin e çdo aspekti ose elementi të Kontratës së Klasifikuar. Një kopje e këtij dokumenti i paraqitet Autoriteteve Kompetente të Sigurisë së Palëve.

4. Në rastin e bisedimeve parakontraktuale ndërmjet organizatave të një Pale, Autoriteti përkatës, Kompetent i Sigurisë, njofton Autoritetin Kompetent të Sigurisë së Palës tjetër për nivelin e klasifikimit të sigurisë të dhënë Informacionit të Klasifikuar në lidhje me ato bisedime para-kontraktuale.

5. Një kopje e seksionit të sigurisë të të gjitha Kontratave të Klasifikuara i paraqitet Autoritetit Kompetent të Sigurisë të Palës ku do të kryhet puna, për të lejuar një mbikëqyrje dhe kontroll të përshtatshëm të standardeve, procedurave dhe praktikave të sigurisë të vendosura nga Kontrak-torët për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

6. Përfaqësuesit e Autoriteteve Kompetente të Sigurisë mund të vizitojnë njëri-tjetrin me qëllim që të analizojnë eficiencën e masave të miratuara nga një Kontraktor, për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të përfshirë në një Kontratë të Klasifikuar.

Neni 11

Vizitat

1. Vizitat që sjellin akses në Informacionin e Klasifikuar për shtetasit e një Pale në Palën tjetër, i nënshtrohen autorizimit paraprak me shkrim të dhënë nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës pritëse.

2. Vizitat që sjellin akses në Informacionin e Klasifikuar lejohen nga një Palë për vizitorët nga Pala tjetër, vetëm nëse ata:

a) kanë marrë leje rregullisht nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë i Palës dërguese, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj të brendshme; dhe

b) janë autorizuar të marrin ose të kenë akses në Informacionin e Klasifikuar, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme të Palës së tyre.

3. Autoriteti Kompetent i Sigurisë i Palës pritëse shqyrton dhe vendos për kërkesën për vizitë dhe informon për vendimin e tij Autoritetin Kompe-tent të Sigurisë të Palës kërkuese.

4. Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës dërguese, njofton Autoritetin Kompetent të Sigurisë të Palës pritëse në lidhje me vizitën e planifikuar nëpërmjet një kërkese për formular vizite, e cila merret të paktën 20 (njëzet) ditë pune para kryerjes së vizitës ose vizitave.

5. Në raste urgjente, kërkesa për formular vizite transmetohet të paktën 10 (dhjetë) ditë pune para.

6. Kërkesa për formular vizite përfshin:

a) emrin dhe mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, shtetësinë, numrin e pasaportës ose të kartës së identitetit të vizitorit;

b) emrin e strukturës, subjektit që përfaqëson vizitori ose të cilit i përket vizitori;

c) emrin dhe adresën e strukturës ose të subjektit që do të vizitohet;

d) sipas rastit, një vërtetim të Certifikatës së Sigurisë të Personelit, vizitorit dhe vlefshmërisë së saj;

e) objektin dhe qëllimin e vizitës ose vizitave;

f) datën dhe kohëzgjatjen e pritshme të vizitës ose të vizitave të kërkuara. Në rastin e vizitave të përsëritura duhet të përcaktohet periudha e plotë e mbuluar nga vizitat;

g) emrin dhe numrin e telefonit të pikës së kontaktit në strukturën ose në organizatën që do të vizitohet, kontaktet e mëparshme dhe çdo informacion tjetër të dobishëm për të përcaktuar justifikimin e vizitës ose vizitave;

h) datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të Autoritetit Kompetent të Sigurisë.

7. Menjëherë pas aprovimit të vizitës, Autoriteti Kompetent i Sigurisë i Palës pritëse i jep një kopje të kërkesës për formular vizite

nëpunësit të sigurisë së subjektit që do të vizitohet.

8. Vlefshmëria e autorizimit për vizitë nuk kalon një vit.

9. Palët mund të bien dakord të përpilojnë lista të individëve të autorizuar për të kryer vizita të përsëritura për çdo projekt, program ose kontratë të veçantë. Këto lista janë të vlefshme për një periudhë fillestare prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.

10. Menjëherë sapo këto lista të jenë aprovuar nga Palët, kushtet e vizitave specifike përcaktohen drejtpërdrejt ndërmjet nëpunësve të sigurisë të subjekteve që do të vizitohen nga këta individë, në pajtim me termat dhe kushtet e rëna dakord.

11. Vizitat në lidhje me Informacionin e Klasifikuar në nivelin e I KUFIZUAR / DIFUSIÓN LIMITADA mund të specifikohen drejtpërdrejt ndërmjet subjektit dërgues dhe subjektit që do të vizitohet.

Neni 12
Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e një shkeljeje sigurie në lidhje me Informacionin e Klasifikuar të dhënë nga Pala tjetër ose nëse dyshohet që Informacioni i Klasifikuar u është deklaruar personave të paautorizuar, Autoriteti Kompetent i Sigurisë i Palës Marrëse njofton menjëherë Autoritetin Kompetent të Sigurisë të Palës dërguese.

2. Pala Marrëse kryen një hetim të menjëhershëm me ndihmën e Palës së Origjinës, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendin e marrësit për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar. Pala Marrëse, menjëherë sapo të jetë e mundur, njofton me shkrim Palën e Origjinës për rrethanat, rezultatin e hetimit dhe masat e marra për të parandaluar përsëritjen.

Neni 13
Shpenzimet

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje normalisht është pa shpenzime.

2. Në rastin e ndonjë shpenzimi të mundshëm, secila Palë mbulon shpenzimet e veta si rezultat i zbatimit dhe i mbikëqyrjes së të gjitha aspekteve të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose me zbatimin e dispozitave të përshkruara në këtë Marrëveshje, zgjidhet me konsultime ndërmjet Palëve.

Neni 15
Ndryshimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me kërkesë të njërës Palë, por mbi bazën e pëlqimit reciprok me shkrim të të dyja Palëve.

2. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me termat e përcaktuar në nenin 16.

Neni 16
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit ndërmjet Palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që shpreh se procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

3. Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast Marrëveshja skadon gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit e denoncimit të saj nga Pala tjetër.

4. Pavarësisht zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, i gjithë Informacioni i Klasifikuar i dhënë ose i gjeneruar në pajtim me këtë Marrëveshje mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të derisa Pala e Origjinës ta çlirojë Palën Marrëse nga ky detyrim.

Bërë në Tiranë, më 17 shkurt 2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën spanjolle, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin e një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Arben Seferi
Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

PËR QEVERINË E MBRETËRISË SË SPANJËS
José de Blas Jiménez
Drejtor i Zyrës Kombëtare të Sigurisë

LIGJ
Nr. 60/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PARADHËNIE PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË PROPOZUAR "SHËRBIME PUBLIKE ME NË QENDËR QYTETARIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për paradhënie për përgatitjen e projektit të propozuar "Shërbime publike me në qendër qytetarin", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9144, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Banka Botërore
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim
dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS
_____, 2015

Shkëlqesisë së Tij, Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: **Shqipëria**

MARRËVESHJE
MBI PARADHËNIEN PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË PROPOZUAR TË SHËRBIMEVE PUBLIKE ME QENDËR QYTETARIN

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), unë kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), propozon t'i japë Marrësit një paradhënie nga Fondi i Përgatitjes së Projektit të Bankës në një shumë që nuk kalon dy milionë dollarë ($ 2.000.000) (Paradhënie), sipas afateve dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë letër marrëveshje (Marrëveshja), të cilat përfshihen në aneksin bashkëlidhur, për të ndihmuar në financimin e veprimtarive të përshkruara në aneksin (Veprimtaritë). Objektivi i aktiviteteve është të lehtësojë përgatitjen e një projekti të propozuar, të projektuar për të përmirësuar efikasitetin, cilësinë dhe qasjen në shërbimet e përzgjedhura publike të Marrësit (Projekti), për kryerjen e të cilave Marrësi i ka kërkuar asistencë financiare Bankës Botërore.

Marrësi përfaqëson, duke konfirmuar dakordësinë e tij si më poshtë, se: a) kupton që ofrimi i Paradhënies nuk përbën detyrim apo nuk nënkupton ndonjë angazhim nga ana e IBRD-së ose IDA-së, për të siguruar financim në mbështetje të Programit; dhe b) është i autorizuar që të lidhë këtë Marrëveshje dhe të kryejë veprimtaritë, të shlyejë Paradhënien dhe të përmbushë detyrimet e tij të tjera në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, nëpërmjet nënshkrimit nga një zyrtar i autorizuar nga Marrësi në datën e parashikuar

në këtë Marrëveshje, si dhe duke ia kthyer Bankës Botërore. Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive në datën në të cilën Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftimin e pranimit të saj të provave në vijim, se: a) ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje është i autorizuar ose i ratifikuar nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare; dhe b) këshilltar i Marrësit i pranueshëm për Bankën Botërore i ka dorëzuar Bankës Botërore një opinion të pranueshëm për Bankën Botërore që kjo Marrëveshje është ratifikuar siç duhet dhe të autorizuar nga Marrësi.

Me respekt,
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga:_____
Tahseen Sayed
Menaxher i Vendit

Republika e Shqipërisë
Rënë dakord

Republika e Shqipërisë
Nga: _____
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

SHTOJCA

1. "Kushtet Standarde për parapagimet e kryera nga Banka Botërore sipas Fondit të Përgatitjes së Projektit" të datës 31 korrik 2010; dhe

2. Letër disbursimi për parapagimin e së njëjtës datë si kjo Marrëveshje, së bashku me "Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për Projektet", të datës 1 maj 2006.

3. "Udhëzime mbi parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-së", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011.

4. "Udhëzime: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbime jokonsulente, sipas huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-së dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 dhe të përditësuara në korrik 2014; dhe

5. "Udhëzime: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve, sipas huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-së dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011, të përditësuara në korrik 2014.

PPA nr. P472

SHTOJCË

Neni 1
Kushtet Standarde; përkufizimet

1.01 Kushtet Standarde. Kushtet Standarde për parapagimet e ofruara nga Banka Botërore në kuadër të objektit për përgatitjen e Projektit, të datës 31 korrik 2010 (Kushtet Standarde), përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale, të përdorur në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që u jepen atyre në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshje.

a) "ADISA" nënkupton Qendrën për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara në Shqipëri, të krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 22 tetor 2014 ose pasardhësit e saj ligjorë.

b) "NJQFK" nënkupton Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit të Ministrisë së Financave të Marrësit.

c) "Departamenti i Jetësimit të Prioriteteve" ose "DJP" nënkupton një njësi në Zyrën e Kryeministrit të Marrësit, përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të prioriteteve të Marrësit, në lidhje me shërbimet publike dhe qeverisjen e mirë.

d) "MSHIAP" nënkupton Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike të Marrësit ose pasardhësit e saj ligjorë.

e) "Qendra e Shërbimeve Publike" ose "QSHP" nënkupton Qendrën e Shërbimeve të Konsoliduara të Marrësit.

Neni 2
Kryerja e veprimtarive

2.01 Përshkrimi i veprimtarive. Veprimtaritë për të cilat ofrohet parapagimi përbëhen nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Hartimi i Modelit të Qendrës për Shërbimet Publike (QSHP):

a) kryerja e një studimi bazë mbi gjendjen aktuale të inventarit të shërbimeve publike;

b) krijimi i një harte të inventarit të shërbimeve publike dhe hartimi i modelit të QSHP-së të përgatitur mbi këtë bazë;

c) krijimi i një mekanizmi për të marrë reagimin e qytetarëve.

Pjesa 2: Krijimi i një Njësie për Menaxhimin e Projektit (NJMP)

Punësimi i personelit të njësisë për menaxhimin e projektit, duke përfshirë edhe një menaxher të projektit, specialist të financave, specialist administrate dhe specialist të prokurimit.

Pjesa 3: Hartimi dhe planifikimi i QSHP-së:

a) kryerja e një konkurrimi për hartimin dhe planimetrinë e QSHP-së;

b) përgatitja e një masterplani të zonës dhe konceptprojektit të QSHP-së;

c) përgatitja e analizave përkatëse për përdorimin e QSHP-së, duke përfshirë numrin e llogaritur të përdoruesve.

Pjesa 4: Hapja e qendrave pilot:

a) krijimi i katër qendrave pilot për shërbimin ndaj qytetarëve për të testuar modelin e QSHP-së dhe për të përmirësuar shërbimin ndaj klientit;

b) monitorimi i qendrave pilote për të dokumentuar mësimet e nxjerra, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike;

c) forcimi i kapacitetit të stafit të ADISA-s nëpërmjet trajnimit, mallrave dhe shërbimeve të konsulentëve.

Pjesa 5: Lançimi i fushatës së komunikimit:

a) përgatitja dhe vënia në zbatim e një fushate komunikimi rreth shërbimeve që do të ofrohen në qendrat pilot;

b) realizimi i veprimtarive për të krijuar një identitet të markës dhe imazh publik për qendrat pilot.

2.02 Kryerja e veprimtarive në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të veprimtarive. Për këtë qëllim, Marrësi do të kryejë veprimtaritë nëpërmjet NJQFK-së të ministrisë së tij të financave, në përputhje me dispozitat e: a) nenit II të Kushteve Standarde; b) nenit II; dhe c) "Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kreditë e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-së", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar të vitit 2011.

2.03 Masat institucionale dhe të tjera. Marrësi garanton që:

a) MSHIAP-ja rekruton personelin e Njësisë së Menaxhimit të Projekteve me kualifikime, përvojë dhe sipas termave të referencës të pranueshëm për Bankën; dhe

b) NJQFK-ja, e mbështetur nga Njësia e Menaxhimit të Projektit, realizon aspektet e mirëbesimit në lidhje me veprimtaritë, duke përfshirë prokurimin, menaxhimin financiar dhe administrimin dhe MSHIAP-ja, agjencia kryesore e zbatimit e mbështetur nga DJP-ja dhe ADISA-ja, një agjenci përfituese në Projekt, realizon aspektet teknike të veprimtarive.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i veprimtarive. Marrësi do të monitorojë dhe do të vlerësojë ecurinë e veprimtarive, në pajtim me dispozitat e seksionit 2.08 të Kushteve Standarde.

2.05 Menaxhimi financiar:

a) Marrësi do të garantojë që një sistem menaxhimi financiar është mbajtur në pajtim me dispozitat e seksionit 2.09 të Kushteve Standarde.

b) Marrësi do të garantojë që raportet financiare të ndërmjetme të paaudituara për veprimtaritë janë të përgatitura dhe i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik që mbulon tremujorin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi duhet të auditojë pasqyrat e tij financiare në pajtim me dispozitat e neneve 2.09/b të Kushteve Standarde, si më poshtë:

i) Nëse në ose para datës së rifinancimit, një Marrëveshje Rifinancuese është ekzekutuar nga të gjitha palët e saj, Marrësi do të përfshijë pasqyrat financiare në auditimin e parë të pasqyrave financiare të kërkuara sipas Marrëveshjes së Rifinancimit;

ii) Nëse, nga data e rifinancimit, asnjë Marrëveshje Rifinancuese nuk është ekzekutuar nga të gjitha palët e saj, auditimi i tillë i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e parapagimit, duke filluar nga viti fiskal gjatë të cilit është kryer tërheqja e parë sipas parapagimit. Pasqyrat financiare të audituara për këtë periudhë do t'i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit fiskal të Marrësit, në të cilin përfshihet data e rifinancimit;

iii) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve "i" dhe "ii" të këtij seksioni, Banka Botërore mund të kërkojë auditimin e pasqyrave financiare para datës së rifinancimit që mbulon këtë periudhë siç është përcaktuar në kërkesën e saj. Pasqyrat financiare të audituara për këtë periudhë do t'i dorëzohen Bankës Botërore, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.06 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e konsulencës që kërkohen për veprimtaritë dhe që duhet të financohen nga fondet e parapagimit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në:

i) Nenin I të "Udhëzimeve: Prokurimi i mallrave, i punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente sipas IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 dhe të përditësuar në korrik 2014 (Udhëzimet e Prokurimit) në rastin e mallrave dhe punimeve;

ii) Nenet I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 dhe të përditësuar në korrik 2014 (Procedurat e Konsulentit) në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii) Dispozitat e këtij seksioni, gjithashtu, do të shtjellohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga ana e Marrësit për veprimtaritë, në pajtim me paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve për Konsulentët (Plani i Prokurimit).

b) Përkufizimet. Termat me germa kapitale, të përdorur në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni, për të përshkruar metoda të veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në nenet II dhe III të Udhëzimeve për Prokurimet apo seksioneve II, III, IV dhe V të Udhëzimeve për Konsulentët, sipas rastit.

c) Metodat e veçanta të prokurimit të mallrave dhe punimeve:

i) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga nënparagrafi "ii" i mëposhtëm, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të dhëna në bazë të Ofertimit Konkurrues Ndërkombëtar;

ii) Metodat në vijim, përveç Ofertimit Konkurrues Ndërkombëtar, mund të përdoren për prokurimin e mallrave dhe të punimeve për kontratat e specifikuara në Planin e Prokurimit: a) Ofertimi Konkurrues Kombëtar, në bazë të dispozitave shtesë të paragrafit të mëposhtëm (d); b) Blerjet; dhe c) Kontraktimi i Drejt-përdrejtë.

d) Ndryshimet në procedurat e Ofertimit Konkurrues Kombëtar të Huamarrësit

Procedurat e Ofertimit Konkurrues Kombëtar (OKK) do të bazohen mbi procedurat e tenderit të hapur siç parashikohet në ligjin për prokurimin publik (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643 i datës 20.11.2006, i ndryshuar), megjithatë, me kusht që kjo procedurë t'u nënshtrohet dispozitave të nenit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

i) Procedurat e "Tenderit të hapur", siç përcaktohen nga LPP-ja e Shqipërisë do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

ii) Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë lloj preference nuk do t'u jepet ofertuesve kombëtarë gjatë procesit të ofertimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen në ofertim vetëm nëse janë të pavarura nga pikëpamja ligjore dhe financiare dhe operojnë sipas së drejtës tregtare të Marrësit. Regjistrimi nuk do të përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

iii) Ofertat do të hapen në publik vetëm në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave, në prani të përfaqësuesve që vendosin të marrin pjesë;

iv) Subjektet ofertuese do të përdorin dokumente tip ofertimi, siç miratohen nga Banka;

v) Në rastet e ofertave me çmime të larta në krahasim me llogaritjen zyrtare, asnjë prej ofertave nuk do të refuzohet pa marrëveshje paraprake me Bankën;

vi) Procedura e një zarfi do të përdoret për dorëzimin e ofertave;

vii) Kualifikimi i mëpasshëm do të kryhet vetëm për ofertuesin me vlerësimin më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në kohën e hapjes së ofertave në bazë të kualifikimeve;

viii) Ofertuesit e formës së sipërmarrjes së përbashkët do të konsiderohen përgjegjës individualisht dhe bashkërisht;

ix) Para se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja, duhet të merret miratimi paraprak i Bankës.

x) Kontrata do t'i jepet ofertuesit me vlerën më të ulët, kryesisht përgjegjës, i cili është konstatuar të jetë i kualifikuar për të përmbushur detyrën në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe të njoftuara paraprakisht;

xi) Negociatat pas ofertimit nuk do të lejohen me ofertuesin, me vlerën më të ulët ose me ndonjë ofertues tjetër;

xii) Kontratat afatgjata (më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozitat përkatëse për përshtatjen e çmimit;

xiii) Garancitë e ofertës dhe të kontratës do të jenë në formën e përfshirë në dokumentet e tenderimit. Garancia e ofertës do të jetë e vlefshme për 28 (njëzet e tetë ditë) pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ose pas çdo periudhe shtyrjeje afati në rastet e kërkuara. Asnjë parapagim nuk do të kryhet pa një garanci të përshtatshme për parapagimin;

xiv) Dokumenti i ofertimit dhe kontrata, siç çmohen të pranueshme nga Banka, do të përmbajnë dispozita që përcaktojnë politikat e Bankës për të sanksionuar firmat ose individët të cilët zbulohen të jenë përfshirë në aktivitete korrupsioni ose mashtrimi, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit;

xv) Në përputhje me Udhëzuesit e Prokurimit, çdo dokument ofertimi dhe kontrate, i financuar nga shumat e Parapagimit, do të garantojnë se ofertuesit, furnitorët dhe kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve ose furnitorët e tyre do t'i lejojnë Bankës inspektimin e llogarive, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të tyre që lidhen me dhënien e ofertave dhe përmbushjen e kontratës dhe të lejojnë që ato të auditohen nga audituesit e caktuar nga Banka. Aktet e synuara për të penguar materialisht ushtrimin e të drejtave të kontrollit dhe të auditimit nga Banka, siç parashikohet nga Udhëzuesit e Prokurimit, përbëjnë praktika penguese siç përcaktohet në Udhëzuesin e Prokurimit.

e) Metodat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të Konsulentëve:

i) Përveç rasteve kur parashikohet në pikën "ii" më poshtë, shërbimet e konsulencës do të prokurohen sipas kontratave të dhëna, bazuar në zgjedhjen mbi bazë cilësie dhe kostoje;

ii) Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra të përcaktuara në Planin e Prokurimit: A) Zgjedhje e bazuar mbi cilësinë; B) Zgjedhje sipas një buxheti fiks; C) Zgjedhje e kostos më të ulët; D) Zgjedhje e bazuar te kualifikimet e Konsulentëve; E) Zgjedhje e një burimi të vetëm të firmave konsulente; F) Zgjedhje e Konsulentëve Individualë; dhe G) Procedurat e një burimi të vetëm për zgjedhjen e Konsulentëve Individualë.

f) Rishikimi i vendimeve të prokurimit nga Banka Botërore. Plani i Prokurimit do të përcaktojë ato kontrata që do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen një rishikimi të mëpasshëm nga Banka Botërore.

Neni 3
Tërheqja e parapagimit

3.01 Shpenzimet e pranueshme. Marrësi mund të tërheqë vlerën e parapagimit në përputhje me dispozitat: a) e nenit III të Kushteve Standarde; b) të këtij paragrafi; dhe c) të udhëzimeve të tilla shtesë që Banka Botërore mund t'ia specifikojë Marrësit me anë të një njoftimi (përfshirë "Udhëzuesin e disbursimit për projekte të Bankës Botërore", të muajit maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe të bërë të zbatueshëm për këtë Marrëveshje, në pajtim me këto udhëzime), që të financojë 100% shpenzimet e pranueshme që përfshijnë mallra, punime, shërbime, trajnime dhe seminare dhe kosto operative rritëse, duke përfshirë taksat.

Për qëllimet e këtij paragrafi, termat:

i) "Trajnime dhe seminare" u referohet kostove të arsyeshme, siç do të jenë miratuar nga Banka Botërore, për trajnimet dhe seminaret e kryera sipas veprimtarive, duke përfshirë kostot e edukimit, udhëtimit dhe të jetesës për pjesëmarrësit e trajnimit dhe seminareve, kosto që shoqërohen me garantimin e shërbimeve të trajnuesit dhe të folësit të seminareve, marrjes me qira të ambienteve për trajnim e seminare,

përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve për trajnim dhe seminare dhe kosto të tjera të lidhura drejtpërdrejt me përgatitjen dhe realizimin e kursit trajnues dhe seminarit (por duke përjashtuar shërbimet e konsulentëve dhe mallrave); dhe

ii) "Kosto operative rritëse" nënkupton kostot e pranueshme, siç do të jenë miratuar nga Banka Botërore, për shpenzimet rritëse të shkaktuara gjatë realizimit të aktiviteteve që përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, kostot e komunikimit dhe sigurimit, tarifat bankare, shpenzimet e qirave, mirëmbajtjen e zyrës (dhe pajisjet e zyrave), shërbimet komunale, fotokopjimin/printimin e dokumenteve, shpenzimet, kostot e udhëtimit dhe dietat për stafin që udhëton në lidhje me realizimin e veprimtarive dhe pagat e personelit të kontraktuar për veprimtaritë (por duke përjashtuar shërbimet dhe pagat e konsulentëve të zyrtarëve të shërbimit civil të Marrësit).

3.02 Data e rifinancimit. Data e rifinancimit është 30.9.2015.

Neni 4

Kushtet e parapagimit

4.01 Interesi. Marrësi do të paguajë interesin për Bilancin e Parapagimit me një këst, për çdo Periudhë Interesi, që është e barabartë me Normën Referuese, plus diferencën fikse. Interesi do të rritet nga data përkatëse e tërheqjes së parapagimit dhe do të paguhet me kamatëvonesë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 4.02 të kësaj Marrëveshjeje. Datat e përfundimit të periudhës së interesit janë 1 janari dhe 1 korriku i çdo viti.

4.02 Shlyerja. Balanca e parapagimit të tërhequr, së bashku me interesin e rritur nga ai moment, do t'i shlyhen Bankës Botërore nga Marrësi sipas dispozitave të nenit IV, të Kushteve Standarde dhe dispozitave të mëposhtme.

a) Rifinancim sipas Marrëveshjes së Rifinancimit. Nëse në ose para datës së rifinancimit, një Marrëveshje Rifinancuese është ekzekutuar nga të gjitha palët e saj, atëherë vlera e plotë e Balancës së Parapagimit të Tërhequr do t'i shlyhet Bankës Botërore (së bashku me interesin e rritur mbi Parapagimin deri në datën e shlyerjes), sapo Marrëveshja e Rifinancimit të hyjë në fuqi, me anë të tërheqjes së një vlere nga Banka Botërore, të shumave të rifinancimit të barasvlershme me Balancën e Parapagimit të Tërhequr plus një interes të tillë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Rifinancimit.

b) Shlyerja në mungesë të një Marrëveshjeje Rifinancuese. Nëse, në ose përpara datës së rifinancimit, nuk është ekzekutuar asnjë Marrëveshje Rifinancuese nga asnjëra prej palëve ose nëse deri në këtë datë, është ekzekutuar por ka përfunduar duke mos qenë më në fuqi, atëherë:

i) Nëse shuma e Balancës së Parapagimit të Tërhequr nuk tejkalon vlerën prej 50.000 $, do t'i shlyhet Bankës Botërore nga Marrësi (së bashku me interesat e rritura mbi Balancën e Parapagimit të Tërhequr deri në datën e shlyerjes), në datën që do të caktojë Banka Botërore në një njoftim drejtuar Marrësit, e cila në asnjë rast nuk do të jetë më herët se 60 ditë nga data kur do të dërgohet një njoftim i tillë; dhe

ii) Nëse shuma e Balancës së Parapagimit të Tërhequr tejkalon vlerën prej 50.000 $ (së bashku me interesat e rritura mbi Balancën e Parapagimit të Tërhequr deri në datën e njoftimit) (Balanca e Përgjithshme), do t'i shlyhet Bankës Botërore nga Marrësi në dhjetë këste, pothuajse të barabarta gjashtëmujore, në vlerën dhe datat (Datat e Pagesës), kur Banka Botërore do t'ia specifikojë Marrësit. Në asnjë rast, data e pagesës së parë nuk do të caktohet para 60 ditëve nga data kur dërgohet njoftimi (Data e Njoftimit). Marrësi do të paguajë interesa te Balanca e Përgjithshme në një normë, për çdo periudhë interesi, që është e barabartë me Normën e Referimit, plus diferencën fikse që mund të paguhet me kamatëvonesë në çdo datë pagese. Pavarësisht nga sa më sipër, në rast se ndonjë vlerë e Balancës së Përgjithshme mbetet e papaguar pas afatit dhe ky mospagim vazhdon për një periudhë 30-ditore, atëherë Marrësi duhet të paguajë Normën e Interesit për Mospagimin për vlerën e vonuar në vend të normës së interesit të përcaktuar sipër, në nënparagrafin "ii", deri në momentin që shuma e vonuar të paguhet tërësisht. Interesi për Normën e Interesit për Mospagimin do të rritet nga dita e parë e Periudhës së Interesit për Mospagimin dhe do të jetë e pagueshme çdo gjashtëmujor me kamatëvonesa në çdo datë pagese.

Neni 5
Përfaqësuesit e Marrësit; adresa

5.01 Përfaqësuesit e Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit, i referuar në seksionin 9.02 të Kushteve Standarde është Ministri i Financave.

5.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit, e referuar në seksionin 9.01 të Kushteve Standarde është:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë,
Republika e Shqipërisë
5.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e referuar në seksionin 9.01 të Kushteve Standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kabllor:
INTBAFRAD
Washington D.C.

Teleks:
248423 (MCI) ose
64145 (MCI)

Faks:
1-202-477-6391

LIGJ
Nr. 61/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) 2014-2020"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9145, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014 - 2020)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si Shqipëria, nga njëra anë, dhe Komisioni Evropian, i referuar më poshtë si "Komisioni", në emër të Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004, Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë[1] në programet e Unionit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se termat dhe kushtet specifikë, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin Program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë;

[1] FZ L 192, 22.7.2005, f. 2.

2. Programi për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) është krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11 dhjetor 2013[2];

3. Sipas nenit 6/b të Rregullores (BE) nr. 1287/2013, vendet aderuese, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë mund të marrin pjesë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe termat dhe kushtet e përgjithshëm për pjesëmarrjen e atyre vendeve në programet e Unionit të krijuara në Marrëveshjet përkatëse Kuadër dhe vendimet e Këshillit të Shoqatës ose marrëveshjeve të ngjashme;

4. Organet e vendosura në Shqipëri do të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet periodike, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si rrjedhojë, kostot e shpenzuara për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon më 2014, do të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që zbatohen për kostot e shpenzuara nga organet e vendosura në shtetet anëtare, me kusht që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (referuar më poshtë si "Programi"), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit, dhe sipas termave dhe kushteve të përmendur në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuar në Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 dhe si më poshtë:

2. Termat dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucionet e ligjshme, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjtë me ata të zbatuara për institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm të shteteve anëtare.

3. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

4. Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e programit do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, në mënyrë që të përmbushen detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

5. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së, në këtë rast gjuha angleze, do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3
Kontributi financiar

Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën I.

Neni 4
Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe me vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi bazën e një partneriteti ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë. Shqipëria do t'i dërgojë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga BE-ja në këtë kontekst.

Raportimi dhe vlerësimi do të kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në shtojcën II.

Neni 5
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit, duke filluar nga 1

[2] FZ L 347, 20.12.2012, f. 33.

janari 2014. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian vendos të zgjasë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, kjo Marrëveshje do të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjëra palë nuk e kundërshton brenda një muaji pas vendimit të zgjatjes së afatit.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga Palët në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit me një njoftim me shkrim, me anë të të cilit informon mbi qëllimin për të përfunduar pjesëmarrjen në Program. Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përfundimi do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim arrin te marrësi.

3. Projektet dhe aktivitetet në proces në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitave të shtojcës II.

4. Shtojcat formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike se ratifikimi i saj i brendshëm ka përfunduar.

Bërë në Tiranë, më 3 mars 2015.

Për Republikën e Shqipërisë:

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Z. Arben Ahmetaj

Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Për Komisionin Evropian:

Në emër të Bashkimit Evropian

Znj. Elzbieta Bienkowska

Komisioneri Evropian për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen dhe SME-të

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME)"

1. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Kontributi financiar për t'u paguar nga Shqipëria për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program do të vendoset në raport me shpërndarjen vjetore në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme të nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e Programit.

2) Kontributi financiar do të llogaritet duke aplikuar faktorin e proporcionalitetit me buxhetin mesatar vjetor të Programit.

3) Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë është marrë nga vendosja e një raporti ndërmjet produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimet e tregut, dhe shuma e produkteve të brendshme bruto, me çmimet e tregut të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

(GDP me çmimet e tregut për Shqipërinë) /(GDP me çmimet e tregut për BE-në 28+ Shqipëria) = faktori i proporcionalitetit. (Faktori i proporcionalitetit) x buxheti mesatar vjetor i Programit = kontributi financiar i Shqipërisë për COSME-n. Buxheti mesatar vjetor = buxheti shumëvjeçar i miratuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 (2298.243 mil € / 7 = (328.32 mil €).

4. Ky raport është llogaritur mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i përkasin të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane (Eurostat), në dispozicion në kohën e negocimit të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo shtojcë përfshin shumat fikse për katër vitet e para të zbatimit të Programit (2014 - 2017).

6. Për pjesën e mbetur të Programit (2018 - 2020), kontributi financiar vjetor do të llogaritet gjatë vitit 2017, duke përdorur të njëjtën formulë,

duke marrë parasysh të dhënat e fundit statistikore dhe çdo ndryshim në buxhetin total të Programit.

7. Kontributet financiare vjetore për t'u paguar nga Shqipëria për buxhetin e Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Programit për periudhën 2014 - 2017 do të jenë si më poshtë: € 235.838.

8. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot e lidhura me zhvillimin dhe ekzekutimin e veprimeve të parashikuara në Program.

9. Kostot e udhëtimit dhe kostot e jetesës të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllime të marrjes pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 21 të Rregullores (BE) 1287/2013 që krijon Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (Komiteti i Menaxhimit të COSME-s), ose takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

10. Rregullorja Financiare e zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

2. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Pasi kjo Marrëveshje të jetë ratifikuar dhe në fillim të çdo viti vijues buxhetor, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një thirrje për fondet që i korrespondojnë kontributit të saj për kostot e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

2) Ky kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit të caktuara në euro.

3) Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për kostot vjetore në përputhje me thirrjen për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria mbi shumën e papaguar që nga data e caktuar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe në rast mospagese 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese të dërguar nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

SHTOJCA II

KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASAT E TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

1. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi Evropian

1) Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura me kontraktuesit dhe përfituesit e Programeve, të vendosura në Shqipëri do të parashikojnë auditime të tjera që do të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e pagesës së pjesës së mbetur. Këto auditime financiare ose auditime të tjera kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre.

2) Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur në vendet e punës, punët dhe dokumentet dhe në të gjitha informacionet e nevojshme, me qëllim kryerjen e auditimeve të tilla, duke përfshirë dhe formën elektronike. Kjo e drejtë aksesi do të shprehet qartë në kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve do të ketë të njëjta të drejta si Komisioni.

3) Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni (OLAF) mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrollet në terren dhe inspektimet në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e vendosura në Rregulloren e Këshillit (Euratom, EC) nr.

2185/96[3] dhe në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013[4] të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur mashtrim, korrupsion apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që ndikon tek interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Euratom.

4) Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

5) Nëse autoritetet shqiptare të përfshira dëshirojnë, kontrollet në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkë me to.

6) Nëse pjesëmarrësit në Programe i rezistojnë kontrollit në terren ose inspektimit, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do t'u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it, mbështetjen e nevojshme për t'i lejuar që të kryejnë detyrën e tyre në realizimin e kontrollit në terren ose inspektimit.

7) Komisioni/OLAF-it do t'i raportojë sa më shpejt që të jetë e mundur autoriteteve të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të evidentuar gjatë kontrollit në terren ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipër-përmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

2. Informacionet dhe konsultimi

1) Për qëllime të zbatimit të përshtatshëm të kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacione dhe me kërkesë të njërës prej palëve, do të kryejnë konsultime.

2) Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisonin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që është sjellë në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi mbi përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Marrë-veshje.

3. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

4. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje të cilat caktojnë një detyrim financiar mbi persona të ndryshëm nga shtetet do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri.

Ekzekutimi do të rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar që qeveria e Shqipërisë do të caktojë për këtë qëllim dhe do t'ia bëjë të ditur Komisionit.

Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë dhe marrëveshje granti, brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të ekzekutueshme me të njëjtat kushte.

PROJEKT

MARRËVESHJE

NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014 - 2020)"

Komisioni Evropian, referuar më poshtë si "Komisioni", në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe qeveria e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si Shqipëria,

Duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton parimet e përgjithshme për

[3] FZ L 292, 15.1.1996, f. 2.

[4] FZ L 248, 18.9.2013, f. 1.

pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë[5] në programet e Unionit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se termat dhe kushtet specifikë, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin Program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë;

2. Programi për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) është krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013[6];

3. Sipas nenit 6 b) të Rregullores (BE) nr. 1287/2013, vendet aderuese, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë mund të marrin pjesë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe termat dhe kushtet e përgjithshëm për pjesëmarrjen e atyre vendeve në programet e Unionit të krijuara në Marrëveshjet përkatëse Kuadër dhe vendimet e Këshillit të Shoqatës ose marrëveshjeve të ngjashme;

4. Organet e vendosura në Shqipëri do të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet periodike, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si rrjedhojë, kostot e shpenzuara për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon në 2014-n, do të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që zbatohen për kostot e shpenzuara nga organet e vendosura në shtetet anëtare, me kusht që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (referuar më poshtë si "Programi"), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit, dhe sipas termave dhe kushteve të përmendur në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1287/2013, dhe si më poshtë:

2. Termat dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucionet e ligjshme, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjta me ato të zbatuara për institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shteteve Anëtare.

3. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

4. Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e programit do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, në mënyrë që të përmbushen detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

5. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së, në këtë rast gjuha angleze, do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3
Kontributi Financiar

Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën I.

Neni 4
Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti, ndërmjet Komisionin dhe Shqipërisë. Shqipëria do t'i dërgojë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga BE-ja në këtë kontekst.

[5] FZ L 192, 22.7.2005, f. 2.
[6] FZ L 347, 20.12.2012, f. 33.

Raportimi dhe vlerësimi do të kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në shtojcën II.

Neni 5
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit, duke filluar nga 1 janari 2014. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian vendos të zgjasë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, kjo Marrëveshje do të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjëra palë nuk e kundërshton brenda një muaji pas vendimit të zgjatjes së afatit.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga Palët në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit me një njoftim me shkrim me anë të të cilit informon mbi qëllimin për të përfunduar pjesëmarrjen në Program. Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përfundimi do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim arrin te marrësi.

3. Projektet dhe aktivitetet në proces në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitave të shtojcës II.

4. Shtojcat formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 6
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Shqipëria njofton Komisionin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se ratifikimi i saj i brendshëm ka përfunduar.

Bërë në:
Për Republikën e Shqipërisë:
Ministër i Republikës së Shqipërisë

Për Komisionin Evropian:
Në emër të Bashkimit Evropian:
A. Tajani
Zëvendëspresident i Komisionit

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (COSME)

1. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Kontributi financiar për t'u paguar nga Shqipëria për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program do të vendoset në raport me shpërndarjen vjetore në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, të nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e Programit.

2) Kontributi financiar do të llogaritet duke aplikuar faktorin e proporcionalitetit në buxhetin mesatar vjetor të Programit.

3) Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë është marrë nga vendosja e një raporti ndërmjet produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimet e tregut, dhe shuma e produkteve të brendshme bruto me çmimet e tregut të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

(GDP me çmimet e tregut për Shqipërinë) /(GDP me çmimet e tregut për BE-në 28+ Shqipëria) = faktori i proporcionalitetit
(Faktori i proporcionalitetit) x buxheti mesatar vjetor i Programit = kontributi financiar i Shqipërisë për COSME-n.
Buxheti mesatar vjetor = buxheti shumëvjeçar i miratuar me Rregulloren (BE) 1287/2013 (2298.243 mil € / 7 = (328.32 mil €)

4) Ky raport është llogaritur mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i përkasin të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane (Eurostat), në dispozicion në kohën e negocimit të kësaj Marrëveshjeje.

5) Kjo shtojcë përfshin shumat fikse për katër vitet e para të zbatimit të Programit (2014 - 2017).

6) Për pjesën e mbetur të Programit (2018 - 2020), kontributi financiar vjetor do të llogaritet

gjatë vitit 2017, duke përdorur të njëjtën formulë, duke marrë parasysh të dhënat e fundit statistikore dhe çdo ndryshim në buxhetin total të Programit.

7) Kontributet financiare vjetore për t'u paguar nga Shqipëria për buxhetin e Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Programit për periudhën 2014 - 2017 do të jenë si më poshtë: € 235.838.

8) Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot e lidhura me zhvillimin dhe ekzekutimin e veprimeve të parashikuara në Program.

9) Kostot e udhëtimit dhe kostot e jetesës të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllime të marrjes pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 21 të Rregullores (BE) 1287/2013, që krijon Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (COSME) (Komiteti i Menaxhimit të COSME-s) ose takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

10) Rregullorja Financiare e zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

2. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Pasi kjo Marrëveshje të jetë ratifikuar dhe në fillim të çdo viti vijues buxhetor, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një thirrje për fondet që i korrespondojnë kontributit të saj për kostot e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

2) Ky kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare të caktuar në euro të Komisionit.

3) Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për kostot vjetore në përputhje me thirrjen për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria mbi shumën e papaguar që nga data e caktuar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit, dhe rast mospagese, 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese të dërguar nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

SHTOJCA II

KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASAT E TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

1. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi Evropian

1) Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura me kontraktuesit dhe përfituesit e Programeve të vendosura në Shqipëri, do të parashikojnë auditime të tjera që do të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e pagesës së pjesës së mbetur. Këto auditime financiare ose auditime të tjera kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre.

2) Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur në vendet e punës, punët dhe dokumentet dhe në të gjitha informacionet e nevojshme, me qëllim kryerjen e auditimeve të tilla, duke përfshirë dhe formën elektronike. Kjo e drejtë aksesi do të shprehet qartë në kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve do të ketë të njëjta të drejta si Komisioni.

3) Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni (OLAF) mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrollet në terren dhe inspektimet në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e vendosura në Rregulloren e Këshillit (Euratom, EC) nr.

2185/96[7] dhe në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013[8] të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur mashtrim, korrupsion apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që ndikon tek interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Euratom.

4) Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe të inspektimeve, në mënyrë që të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

5) Nëse autoritetet shqiptare të përfshira dëshirojnë, kontrollet në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkë me to.

6) Nëse pjesëmarrësit në Programe i rezistojnë kontrollit në terren ose inspektimit, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do t'u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it mbështetjen e nevojshme për t'i lejuar që të kryejnë detyrën e tyre në realizimin e kontrollit në terren ose inspektimit.

7) Komisioni/OLAF-i do t'u raportojë sa më shpejt që të jetë e mundur autoriteteve të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të evidentuar gjatë kontrollit në terren ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit /OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

2. Informacionet dhe konsultimi

1) Për qëllime të zbatimit të përshtatshëm të kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacione, dhe me kërkesë të njërës prej palëve, do të kryejnë konsultime.

2) Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisonin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që është sjellë në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi mbi përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

3. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

4. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, të cilat caktojnë një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet, do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri.

Ekzekutimi do të rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar që Qeveria e Shqipërisë do të caktojë për këtë qëllim dhe do t'ia bëjë të ditur Komisionit.

Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë dhe marrëveshje granti brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të ekzekutueshme me të njëjtat kushte.

LIGJ
Nr. 62/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9482, DATË 3.4.2006, "PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

[7] FZ L 292, 15.1.1996, f. 2.
[8] FZ L 248, 18.9.2013, f. 1.

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e parë të pikës 1, shprehja "për objektet e ndërtuara pa leje deri më 15.1.2009" zëvendësohet me shprehjen "për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014".

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 4, shprehja "në pikat 1, 2 dhe 3" zëvendësohet me shprehjen "në pikat 1 dhe 3".

Neni 2

Në nenin 3, shkronja "gj/1" shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 17, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet:

a) Në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefishit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m^2.

b) Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefishit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit.

c) Kur për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkese me shkrim.

ç) Lista e poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe sipërfaqet e parcelave ndërtimore, për të cilat kryhet kalimi i pronësisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Procedurat dhe rregullat që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 4

Në nenin 27, shkronja "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin me leje, apartamentin dhe njësinë e shërbimit, në rastin e shtesave pa leje të realizuara në këto ndërtime.".

Neni 5

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Për regjistrimin e pasurisë së legalizuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ZRPP-ja zbaton dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimet pasurore martesore.".

Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Rregullat e bashkërendimit të punës ndërmjet ALUIZNI-t dheZQRPP-së, si dhe procedurat apo kufizimet që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 44

Kundër vendimit të Drejtorisë së ALUIZNI-t për kualifikimin për legalizim, përjashtimin nga legalizimi dhe dhënies së lejes së legalizimit, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.".

Neni 7

Në nenin 45/1, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Ndërtimet pa leje, të përfshira në fushën e zbatimit të këtij ligji, nuk u nënshtrohen procedurave, afateve dhe kushteve që lidhen me vetëdeklarimin pranë njësive të qeverisjes vendore.".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9146, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 63/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME NËN FONDIN E PËRBASHKËT EUROPIAN TË BALLKANIT PERËNDIMOR, PËR PROJEKTIN E DETAJUAR TË LINJËS HEKURUDHORE DURRËS - TIRANË DHE VLERËSIMIN FINANCIAR /EKONOMIK TË TË GJITHË RRJETIT HEKURUDHOR NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe vlerësimin financiar / ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9147, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJA E GRANTIT
PËR PROJEKTIN E DETAJUAR TË LINJËS HEKURUDHORE DURRËS-TIRANË DHE VLERËSIMIN FINANCIAR/EKONOMIK TË TË GJITHË RRJETIT HEKURUDHOR SHQIPTAR NË SHQIPËRI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME NËN FONDIN E PËRBASHKËT EVROPIAN TË BALLKANIT PERËNDIMOR
xx xx 2014

Marrëveshja e Grantit nr. C25990/WBES-2013-03-02, në datën xx xx 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministri i Financave (Marrësi) dhe Bankës Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka ose BERZH) me Zyrat Qendrore në *One Exchange Square, London EC2A 2JN*, *United Kingdom*, një institucion financiar i krijuar në përputhje me Marrëveshjen për Themelimin e Bankës, firmosur në Paris, më 29 maj 1990, që vepron si administrator i fondeve të grantit, të cilat mbahen në Fondin e Veçantë të Aksionerëve të BERZH-it dhe nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor, të siguruara nga qeveri të ndryshme (së bashku, Donatorët).

HYRJE

Duke pasur parasysh se Bankës i është kërkuar të ofrojë bashkëpunim teknik për Marrësin në formën e shërbimeve të konsulencës financiare për Projektin e Detajuar të Linjës Hekurudhore dhe Vlerësimin Financiar/Ekonomik të të Gjithë

Rrjetit Hekurudhor Shqiptar (Projekti), duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes (Shërbimet);

duke pasur parasysh se Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) duhet të sigurojë një konsulent (Konsulenti), në përputhje me politikat dhe rregullat për prokurim dhe me procedurat e tjera të BERZH-it;

duke pasur parasysh se MTI-ja do të lidhë një Kontratë Konsulence për parashikimin e Shërbimeve të Konsulentit (Kontrata e Konsulencës) për shumën tavan deri në 1,103,000.00 euro;

duke pasur parasysh se sipas Marrëveshjes së Fondeve për Bashkëpunim Teknik, ndërmjet Donatorit dhe Bankës, Donatori ka rënë dakord dhe ka miratuar vënien në dispozicion të fondeve deri në vlerën 1,103,000.00 euro në formën grant (Granti), për të financuar Shërbimet e Konsulentit sipas kushteve të mëposhtme;

duke pasur parasysh se Marrësi do të ndërmarrë çdo masë të nevojshme në përputhje me ligjin shqiptar për ta bërë Grantin të disponueshëm për MTI-në, me anë të një marrëveshjeje për transfertë, për qëllimin e specifikuar në kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje;

duke pasur parasysh se Marrësi duhet të përcaktojë si kusht për marrjen e Grantit se, për të përfituar Shërbimet, MTI-ja duhet të pajtohet me të gjitha detyrimet kontraktuale të përcaktuara në këtë Marrëveshje për Grantin për MTI-në;

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.

Për këtë arsye, palët bien dakord me kushtet në vijim:

Neni 1
Përkufizimet

1.01 Përkufizimet dhe interpretimi

Termat e mëposhtëm me shkronjë të madhe do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë, në cilëndo pjesë të kësaj kontrate, me përjashtim të rastit kur konteksti kërkon një tjetër kuptim:

a) "Kostot e detyrës" do të thotë kostoja e Shërbimeve;

b) "Banka ose BERZH" do të thotë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;

c) "MTI" do të thotë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), palë së cilës do t'i ofrohen Shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës;

d) "Angazhimi i MTI-së" do të thotë kontributi financiar i ofruar nga MTI-ja për koston e Shërbimeve;

e) "Konsulenti" do të thotë pala e cila do të realizojë Shërbimet;

f) "Kontrata e Konsulencës" do të thotë marrëveshja që do të vendoset midis MTI-së dhe Konsulentit për realizimin e Shërbimeve;

g) "Vendi i detyrës" është Shqipëria;

h) "Donatori" do të thotë ofruesi i fondeve të Grantit, siç edhe specifikohet në Hyrjen e kësaj Marrëveshje;

i) "Grant" do të thotë shuma e fondeve të vëna në dispozicion nga Dhuruesi për Bankën, si administrator, për qëllimet e financimit të Kontratës së Konsulencës;

j) "Marrëveshja e Grantit" do të thotë kjo marrëveshje dhe të gjitha shtojcat bashkëngjitur, duke pasur parasysh se ajo mund të redaktohet herë pas here;

k) "Shuma Maksimale e Kontratës" do të thotë shuma deri në 1,103,000.00 euro, e cila duhet t'i paguhet Konsulentit sipas një Kontrate Konsulence, duke përfshirë të gjitha tarifat, kuotat dhe shpenzimet;

l) "Drejtuesi i Operacionit" do të thotë anëtari i stafit të Bankës, i cili është përgjegjës për monitorimin e implementimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës;

m) "Marrësi" do të thotë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave;

n) "Shërbimet" do të thotë Shërbimet e realizuara nga Konsulenti për MTI-në, siç përcaktohet në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referencë në një akt është për atë akt dhe për rregullat e përcaktuara sipas atij akti, duke qenë se ai akt dhe rregullat mund të amendohen ose të modifikohen në çdo kohë, si edhe ndaj çdo akti ose rregulli që mund të miratohet dhe që ka efekt plotësues ose zëvendësues për atë akt apo rregull.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj çdo gjinie përfshin referencën ndaj të gjitha gjinive të tjera, numri njëjës përfshin shumësin dhe e anasjella, dhe referencat ndaj personave përfshijnë korporatat, shoqëritë jo të inkorporuara dhe partneritetet. Referenca ndaj një personi përfshin pasuesit dhe personat të cilëve iu janë kaluar të drejtat.

Neni 2
Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord të vendosë në dispozicion të Marrësit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Grantin në shumën e cila nuk e kalon vlerën 1,103,000.00 euro apo ekuivalenten e saj.

b) Granti do të aplikohet vetëm për të financuar Shërbimet gjatë periudhës së angazhimit të Konsulentit.

2.02 Pagesa

a) Marrësi dhe Banka bien dakord që Banka është e autorizuar ta paguajë Konsulentin direkt në emër të MTI-së.

b) Shuma e Grantit do t'i paguhet Konsulentit direkt nga Banka në emër të dhe sipas udhëzimeve të MTI-së, në përputhje me dispozitat në Kontratën e Konsulencës.

c) Sapo të merret fatura dhe dokumentet mbështetëse të dërguara nga Konsulenti, në përputhje me parashikimet e Kontratës së Konsulencës, MTI-ja do të kontrollojë dhe do të verifikojë sa më shpejt të jetë e nevojshme faturën dhe përmbushjen e kënaqshme të atyre Shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse Shërbimet rezultojnë të jenë të kënaqshme dhe MTI-ja është e kënaqur me faktin se shumat e tarifuara në faturë korrespondojnë me shumat e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës, atëherë fatura, e cila është në mbështetje të dokumenteve dhe një deklarate (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), e cila certifikon miratimin e Shërbimeve, duhet t'i dërgohet Bankës për të bërë pagesën në Bank's Tirana Resident Office, ndërtesa "Torre Drin", kati i 4-t, rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri.

2.03 Taksat dhe detyrat

a) MTI-ja bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të paguar taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në), të lidhura me Shërbimet apo me këtë Marrëveshje Granti, të përcaktuar sipas ligjeve dhe rregullave, të cilat janë në fuqi në vendin e detyrës.

b) MTI-ja do ta këshillojë Bankën nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme në përputhje me Kontratën e Konsulencës.

c) MTI-ja bie dakord se çdo taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme do t'i paguhet Konsulentit nga MTI-ja.

d) Nëse ndonjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e tarifueshme, në momentin kur Bankës t'i dërgohet vërtetimi sipas klauzolës 2.02/d, edhe MTI-ja duhet të vërtetojë pagesën e vet të bërë për taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme në cilëndo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe, gjithashtu ,të marrë përsipër të paguajë taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në faturën aktuale.

e) Nëse MTI-ja nuk paguan ndonjë nga taksat indirekte (duke përfshirë TVSH-në), kjo Marrëveshje mund të ndërpritet sipas klauzolës 5.03.

Neni 3
Zbatimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe MTI-ja duhet të bashkëpunojnë plotësisht për sa i përket administrimit të Kontratës së Konsulencës.

Herë pas here, bazuar në kërkesën e ndonjërës prej tyre, Banka, Marrësi dhe MTI-ja do të shkëmbejnë mendimet në lidhje me progresin e Projektit, Shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet ky Grant, përmbushjen e detyrimeve që ka MTI-ja në përputhje me këtë Marrëveshje dhe përmbushjen e detyrimeve që ka MTI-ja dhe Konsulenti bazuar në Kontratën e Konsulencës, si edhe t'i sigurojë palës tjetër të gjitha informacionet e nevojshme bazuar në kërkesën e kësaj pale.

b) MTI-ja duhet të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar për natyrën dhe qëllimin e Projektit apo të Shërbimeve, apo biznesit ose operacioneve të MTI-së dhe të çdo zhvillimi apo kushti, i cili

mund të ndikojë materialisht mbarëvajtjen e Projektit apo të Shërbimeve, apo të biznesit ose të operacioneve të MTI-së.

c) Pa cenuar tërësinë e sa më sipër, MTI-ja nuk duhet të bëjë ndryshime materiale, duke përfshirë këtu edhe ndonjë vendim që lidhet me detyrën dhe nënkontraktimin në Kontratën e Konsulencës, pa marrë fillimisht pëlqimin me shkrim të Bankës, pëlqim i cili nuk mund të kundërshtohet pa pasur arsye. Në çfarëdo rasti, Banka duhet të njoftohet nga MTI-ja për të gjitha ndryshimet në Kontratën e Konsulencës.

3.02 Relacione dhe raporte

a) MTI-ja duhet:

i) të kujdeset për mbarëvajtjen e procedurave dhe të relacioneve, të përshtatshme për regjistrimin dhe monitorimin e progresit të Shërbimeve (duke përfshirë kostot dhe përfitimet, të cilat burojnë prej tyre), si edhe të identifikojë Shërbimet e financuara nga Granti, dhe t'i ketë të disponueshme këto relacione për përfaqësuesit e Bankës sipas kërkesës së vetë Bankës;

ii) të kujdeset për mbarëvajtjen e llogarive dhe të vërtetimeve financiare (bilancet, vërtetimet e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe vërtetime të tjera të lidhura me to), të cilat janë të nevojshme për të monitoruar dhe për të regjistruar progresin e Shërbimeve, duke përfshirë kostot dhe përfitimet të cilat burojnë nga këto Shërbime, si edhe të pajisë Bankën sipas kërkesave të saj me kopje të këtyre informacioneve, me të gjitha detajet sipas kërkesës së Bankës;

iii) t'u bëjë të mundur përfaqësuesve të Bankës, sipas kërkesës së Bankës, të kontrollojnë çdo mjet të përfshirë, apo të përmendur në Projekt apo në Kontratën e Konsulencës, si edhe të kontrollojnë Shërbimet e financuara nga Granti, si edhe çdo impiant, instalim, vend, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, relacion dhe dokument të lidhur me përmbushjen e detyrimeve të MTI-së apo të Konsulentit në përputhje me këtë Marrëveshje apo Kontratë Konsulence;

iv) të pajisë përfaqësuesit e Bankës me informacione të tilla, sipas kërkesës së Bankës, në lidhje me Projektin dhe Shërbimet, koston e tyre, dhe kur të jetë e përshtatshme, me përfitimet që priten të burojnë prej tyre, si edhe me shpenzimin e të ardhurave të Grantit;

v) të pajisë ose të mundësojë pajisjen e përfaqësuesve të Bankës me planet, specifikat, raportet, kontratat, dokumentet (duke përfshirë rezultatet në përputhje me Kontratën e Konsulencës), si edhe modifikimet apo shtesat në çdo material, sipas kërkesave të Bankës;

b) Menjëherë pas përmbushjes së Shërbimeve, MTI-ja duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Bankës një raport me një gjuhë të detajuar, me shtrirje dhe me detaje të tilla që përputhen me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në lidhje me zbatimin dhe mbarëvajtjen e Shërbimeve, me koston dhe me përfitimet e marra prej tyre, si edhe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve respektive nga ana e MTI-së, Konsulentit dhe të Bankës, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe Kontratën e Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjitha raportet dhe relacionet e përgatitura nga MTI-ja duhet të hartohen në *Microsoft Word* dhe/ose në *Excel*, të jenë të konvertueshme në *Acrobat* dhe të dorëzohen në formë dokumenti dhe në formë elektronike.

3.03 Konfidencialiteti

Përveç rasteve kur është dhënë pëlqimi paraprak me shkrim i Bankës, MTI-ja dhe Marrësi nuk duhet të zbulojnë apo të lejojnë që agjentët e tyre apo nënkontraktorët t'u zbulojnë palëve të treta, dhe as të përdorin për qëllimet e tyre, çfarëdolloj informacioni në lidhje me Shërbimet, Projektin apo Bankën, duke përfshirë informacione në lidhje me Kontratën e Konsulencës. MTI-ja dhe Marrësi mund të ofrojnë të dhëna dhe informacione të tilla, nëse kërkohet nga ligji apo rregullorja në fuqi, por vetëm atë pjesë të informacionit, e cila me aq sa lejon ligji apo rregullorja respektive, kërkohet ligjërisht që të ofrohet. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, MTI-ja dhe Marrësi duhet të informojnë menjëherë Bankën.

3.04 Drejtimi i operacioneve

Nëse Banka nuk ka mendim tjetër, atëherë MTI-ja duhet të drejtojë biznesin dhe operacionet e saj (duke përfshirë edhe operacionet për çdo degë) në përputhje me standardet dhe praktikat administrative, teknike, financiare dhe mjedisore, të njohura ndërkombëtarisht, nën mbikëqyrjen e një menaxhimi të kualifikuar dhe me eksperiencë, të asistuar nga një staf kompetent dhe të mjaftueshëm.

3.05 Mbështetja e Marrësit

Marrësi duhet:

i) të përmbushë siç duhet detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) të mbështesë MTI-në të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ndërmarrjen e të gjitha masave legjislative e rregulluese apo të masave të tjera të nevojshme apo të përshtatshme, si edhe duke përcaktuar apo duke mundësuar sigurimin e fondeve dhe mbështetjes për MTI-në, kur këto fonde t'i nevojiten MTI-së për të realizuar Projektin; dhe

iii) të ndërmarrë çdo masë, në përputhje me ligjin shqiptar për ta vënë këtë Marrëveshje në zbatim.

Neni 4

Përfaqësimi

4.01 Përfaqësuesi i Autorizuar

Çdo masë e kërkuar apo e lejuar për t'u ndërmarrë, si edhe çdo akt i kërkuar apo i lejuar që të zbatohet, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmerret ose do të zbatohet:

a) në emër të marrësit nga z. Shkëlqim Cani apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe

b) në emër të MTI-së nga ministri i MTI-së apo nga një përfaqësues i emëruar; dhe

c) në emër të Bankës nga drejtori, Konsulenca dhe Departamenti i Prokurimit të Korporatës apo nga cilido përfaqësues i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftime ose kërkesa

Çdo njoftim, kërkesë apo miratim i kërkuar apo i lejuar për t'u dhënë apo bërë, në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet të hartohet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë apo miratim do të konsiderohet si i dhënë apo i bërë kur dorëzohet personalisht te përfaqësuesi i autorizuar i palës së cilës i adresohet komunikimi ose kur i dërgohet me postë të regjistruar apo me faks palës në adresën e mëposhtme:

Për Marrësin
Për: Z. Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Adresa: Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri
Telefon: + 355 4 2228405
Faks: + 355 4 222 8494

Për MTI:
Për: Z. Edmond Haxhinasto
Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës
Adresa: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sheshi "Skëndërbej", nr. 5, Tiranë, Shqipëri
Telefon: + 355 4 2234647
Email: edmond.haxhinasto@transporti.gov.al

Për Bankën:
Për: Donald Mishaxhiu
"Drejtuesi i Operacionit"
Adresa: European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2 JN, Mbretëria e Bashkuar
Telefon: +44 207 338 7109
Faks: +44 207 338 7301
Email: mishaxhd@ebrd.com

a) Njoftimi do të konsiderohet i vlefshëm për sa më poshtë:

i) në rast të dorëzimit personalisht apo me anë të postës së regjistruar për shpërndarjen; dhe

ii) në rast të fakseve të cilat ndjekin transmetimin e konfirmuar.

b) Një palë mund ta ndryshojë adresën për dorëzimin e njoftimeve apo kërkesave, duke njoftuar palën tjetër në përputhje me këtë klauzolë.

Neni 5

Pezullimi dhe ndërprerja

5.01 Njoftim i MTI-së

MTI-ja duhet të njoftojë menjëherë Bankën për pezullimin apo ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës, apo për çdo zhvillim i cili mund të çojë në pezullimin apo ndërprerjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i pagesave

Nëse ndodh një nga zhvillimet e mëposhtme dhe ky i fundit ndodh që të jetë në vazhdimësi, Banka, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit, pezullon menjëherë pagesën për Konsulentin pjesërisht ose plotësisht, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje:

a) nëse pezullohet Kontrata e Konsulencës ose nëse Kontrata e Konsulencës ndërpritet, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

b) nëse MTI-ja nuk ka paguar taksat indirekte (duke përfshirë edhe TVSH-në) për faturat e Konsulentëve për Konsulentin në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

c) nëse ka pasur ndonjë rrethanë tjetër, e cila sipas opinionit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyn ose kërcënon të ndërhyjë në mbarëvajtjen e suksesshme të Shërbimeve apo të Projektit, ose në përmbushjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje, nëse:

i) Ndonjë nga kushtet e përmendura në klauzolën 5.02 vazhdon për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi Banka ka pezulluar plotësisht apo pjesërisht pagesat për Konsulentin dhe ka njoftuar me shkrim Marrësin; ose

ii) Kontratës së Konsulencës i ka mbaruar afati ose është ndërprerë në përputhje me kushtet; ose

iii) Marrësi dhe Banka bien dakord ta ndërpresin atë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) Dhuruesi pezullon financimin e Grantit; ose

v) prokurimi i ndonjërit prej Shërbimeve është i papajtueshëm me këtë Marrëveshje; ose

vi) fondet e paguara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të tjera nga ato të parashikuara në këtë marrëveshje.

b) Për çdo zhvillim, Banka mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo moment, duke njoftuar fillimisht me shkrim Marrësin në një periudhë kohore jo më pak se dyzet ditë.

5.04 Procedura e ndërprerjes

Me ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, sipas klauzolës 5.03, MTI-ja do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të reduktuar humbjet dhe për t'i mbajtur në minimum shpenzimet e tjera, sipas Kontratës së Konsulencës.

Neni 6
Të përgjithshme

6.01 Përjashtimi i detyrimeve

Pavarësisht çdo dispozite tjetër në këtë Marrëveshje, Banka nuk është përgjegjëse ndaj Marrësit, MTI-së apo Konsulentit, sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kontratës së Konsulencës, për humbjet apo dëmet, edhe pse ato janë shkaktuar ose nuk janë shkaktuar nga neglizhenca apo pakujdesia e Bankës. Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin kur neglizhenca apo pakujdesia e Bankës shkakton vdekjen apo dëmtimin personal të MTI-së apo të personelit të Konsulentit, apo të Ekspertëve.

6.02 Zhdëmtimi

MTI-ja zhdëmton dhe, sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, mbron Bankën, drejtorët, oficerët, punonjësit, agjentët dhe kontraktuesit e saj ndaj të gjitha kërkesave, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, masave, humbjeve, të cilat lindin, kanë lidhje ose jo me çfarëdo veprimi ose pakujdesie nga ana e MTI-së apo Konsulentit, punonjësve, nënkontraktorëve apo agjentëve të tyre, edhe nëse ai mund të jetë i tërthortë, neglizhent apo i ndonjë forme tjetër, ose ndonjë shkelje prej tyre ndaj detyrimeve që ata kanë sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës apo çdo pamundësie nga ana e tyre për t'iu përmbajtur akteve, rregullave apo normave.

6.03 Praktikë e ndaluar

Banka, pa ndonjë paragjykim për çdo kompensim për shkelje të Marrëveshjes, mund ta ndërpresë menjëherë këtë Marrëveshje nëse Marrësi, dhe/ose MTI-ja, sipas gjykimit të Bankës, janë përfshirë në praktika të ndaluara gjatë konkurencës për Kontratën e Konsulencës apo gjatë zbatimit të saj.

"Praktikë e korruptuar" do të thotë të ofrosh, të japësh, të marrësh apo të kërkosh në mënyrë direkte apo indirekte çdo gjë me një vlerë të tillë që mund të ndikojë në mënyrën e gabuar në veprimet e një pale tjetër, në lidhje me procesin e përzgjedhjes apo në zbatimin e Kontratës, në mënyrë që të sigurojë apo të ruajë biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm në administrimin e biznesit.

"Praktikë mashtruese" do të thotë çdo veprim apo pakujdesi, duke përfshirë edhe një keqpërfaqësim, i cili me qëllim apo për pakujdesi mund të mashtrojë një palë që kjo e fundit të sigurojë një përfitim financiar apo një përfitim të një natyre tjetër, apo të shmangë një detyrim.

"Praktikë detyruese" do të thotë të përkeqësosh apo të dëmtosh, apo të kërcënosh të përkeqësosh ose të dëmtosh në mënyrë direkte ose indirekte,

cilëndo palë apo pronë të palës, për të ndikuar negativisht në veprimet e palës për sa ka të bëjë me procesin përzgjedhës apo me zbatimin e Kontratës, në mënyrë që të përvetësosh apo të ruash biznesin apo ndonjë avantazh tjetër të papërshtatshëm gjatë administrimit të biznesit.

"Praktikë e fshehtë dhe mashtruese" do të thotë një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve me qëllimin për të përmbushur një objektiv të gabuar, duke përfshirë edhe ndikimin e keq në veprimet e një pale tjetër, dhe përfshin çdo marrëveshje midis konsulentëve (përpara apo pas dorëzimit të propozimeve), me synimin për të përcaktuar çmime në nivele artificiale jokonkurruese dhe për të privuar MTI-në nga përfitimet e konkurencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

MTI-ja duhet të lejojë Bankën ose përfaqësuesin e saj të autorizuar të inspektojë llogaritë dhe të dhënat e saj në lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe Shërbimeve, si edhe të lejojë auditimin e këtyre llogarive nga auditët e caktuar nga Banka, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimet

Të pazbatueshme

6.06 Ligji drejtues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me ligjet angleze. Çdo detyrim jokontraktual, i cili paraqitet jashtë apo në përputhje me këtë Marrëveshje, administrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet angleze.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim i cili lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, apo nga shkelja, ndërprerja apo shfuqizimi, apo çdo detyrim jokontraktual që lind nga kjo Marrëveshje apo në lidhje me të, i cili nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, zgjidhet me anë të arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL-it (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjet Tregtare Ndërkombëtare - KKBLTN), të cilat janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Duhet të jetë 1 (një) arbitër, ndërsa autoriteti emërues për qëllimet e Rregullave të UNCITRAL (KKBLTN) duhet të jetë Gjykata Londineze e Arbitrazhit Ndërkombëtar (GJLAN). Vendi i arbitrazhit duhet të jetë Londra, Anglia, dhe gjuha angleze duhet të përdoret gjatë gjithë procedurave arbitrare. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas aktit të Arbitrazhit, i vitit 1996, ose në të kundërt ato duhet të apelojnë për arbitrazh apo të kërkojnë përcaktimin e një ligji paraprak nga gjykatat e Anglisë apo diku tjetër. Arbitri nuk është i autorizuar të ndërmarrë masa të përkohshme ndaj Bankës, pavarësisht dispozitave të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it (KKBLTN-së) dhe MTI-ja duhet të bjerë dakord se nuk do t'i kërkojë ato nga asnjë autoritet gjyqësor.

c) Asnjë element në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si dorëheqje, tërheqje apo modifikim nga ana e Bankës në lidhje me imunitetet, privilegjet apo përjashtimet e Bankës, sipas Marrëveshjes për Ndërtimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, sipas konventës ndërkombëtare apo çdo ligji të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka ka bërë një kërkesë të posaçme për arbitrazh sipas seksionit 6.06/b të kësaj Marrëveshjeje, dhe në përputhje dhe pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e saj (duke përfshirë, pa limit paprekshmërinë e arkivave të saj), ajo pranon se nuk ka imunitet ndaj procesit gjyqësor, sipas nenit 5/2 të Instrumentit të Statutit 1991, nr. 757 (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Imunitetet dhe Privilegjet) urdhri 1991), apo ndonjë dispozite tjetër sipas ligjeve angleze, në lidhje me zbatimin e një vendimi arbitrazhi kundër saj, si rezultat i kërkesës së saj të posaçme për arbitrazh në zbatim të seksionit 6.06/b të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Efikasiteti

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi sapo të përfundojnë procedurat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi, në përputhje me ligjin shqiptar, dhe nëse nuk pezullohet apo ndërpritet në përputhje me nenin 5, dhe mbetet në fuqi derisa të plotësohen Shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Amendimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të amendohet vetëm me mirëkuptimin me shkrim midis Bankës dhe Marrësit, i zbatuar sipas rregullave nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 E gjithë Marrëveshja

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjitha shtojcat bashkëngjitur, e amenduar herë pas here në përputhje me Klauzolën 6.08, përmban të gjithë

arsyetimin dhe marrëveshjen midis palëve dhe pezullon të gjitha propozimet apo marrëveshjet e tjera në lidhje me subjektin e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë palë nuk mbështetet në sipërmarrjen apo përfaqësimin nga ndonjë palë tjetër, e cila nuk është pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasuesit

Kjo Marrëveshje lidhet dhe hyn në zbatim për përfitimet e pasuesve respektivë dhe të perso-nave të cilëve iu janë kaluar të drejtat e palëve.

6.11 Përjashtimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon ndonjë të drejtë sipas Aktit të Kontratave (të drejtat e palëve të treta) 1999, e zbatueshme nga persona apo entitete të cilat nuk janë palë me të, me përjashtim të rastit kur një entitet apo person, i cili është pasues ose të cilit i janë kaluar të drejtat e një pale, mendohet të jetë palë me këtë Marrëveshjeje.

6.12 Klauzolat që mbeten në fuqi

Klauzolat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 do t'i mbijetojnë ndërprerjes apo mbarimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja është gjuha e Marrëveshjes. I gjithë komunikimi, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës së Konsu-lencës duhet të përgatitën dhe prezantohen në gjuhën angleze. Gjatë çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me gjuhën mbizotëron versioni i anglishtes.

6.14 Garanci të tjera

Herë pas here, me kërkesën e Bankës, MTI-ja duhet të angazhohet vetë ose të angazhojë Konsulentin, të përmbushë dhe të shpërndajë dokumente të tjera, si edhe të bëjë këto akte të tjera në përputhje me kërkesat e arsyeshme të Bankës, në mënyrë që të tregojë, drejtojë dhe t'i japë efekt të plotë ligjor kushteve, qëllimit dhe domethënies së kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Respektimi i afateve

E pazbatueshme.

6.16 Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të përgatitet në tri kopje, secila duhet t'i përmbahet një dhe së njëjtës Marrëveshjeje.

6.17 Logoja e BERZH-it

MTI-ja dhe Marrësi informohen se logoja e Bankës është një simbol i regjistruar shërbimi; dhe as MTI-ja dhe as Marrësi nuk mund ta riprodhojnë një logo të tillë pa lejen e posaçme me shkrim të Bankës.

Në prani të dëshmitarëve, palët, me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë firmosur këtë Marrëveshje në tri kopje, në gjuhën angleze, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave

……..

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Data: ……..

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Stephen Gillard

Kryekëshilltar

Bashkëpunim Teknik

Datë: …….

SHTOJCA A

PËR MARRËVESHJEN E GRANTIT

FORMULARI I DEKLARATËS PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

Të firmoset nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe të dërgohet nga Konsulenti me faturat për Shërbimet.

Fatura nr. Data e faturës: Shuma e faturës:

Marrëveshja e Grantit nr.: C25990/WBES-2013-03-02 OL: Donald Mishaxhiu

1. Në vijim të Kontratës së Konsulencës për [Shërbimet], në datën _____, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës [MTI] dhe …… [Konsulenti]; dhe në vijim të klauzolës 2.02/d të Marrëveshjes së Grantit për Shërbimet, më datë xxxxxx, ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim [Banka] dhe Marrësit, MTI-ja pohon se:

i) MTI-ja ka marrë dhe është e kënaqur me Shërbimet e Konsulentit, për të cilat është kontraktuar në Kontratën e Konsulencës, Shërbime të cilat mbulohen nga faturat bashkëlidhur;

ii) MTI-ja ka kontrolluar faturat dhe të gjitha dokumentet mbështetëse, të cilat kanë lidhje me përmbushjen e Shërbimeve kundrejt shumave të përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe siguron se:

a) Fatura/faturat është/janë një pasqyrim i vërtetë i Shërbimeve të ofruara nga Konsulenti; dhe

b) Shuma/shumat e/të tarifuar/a në faturë/a korrespondon/jnë me shumën/shumat e përcaktuar/a në Kontratën e Konsulencës;

iii) fatura/t dhe të gjitha dokumentet mbështetëse janë dërguar së bashku me këtë deklaratë për miratim, adresuar Skuadrës së Faturimit TC, Njësia e Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesën; dhe

iv) MTI-ja ka paguar çdo taksë indirekte, duke përfshirë TVSH-në për Konsulentin, sipas faturave të mëparshme dhe merr përsipër të paguajë faturat indirekte duke përfshirë TVSH-në në lidhje me faturën/faturat bashkëlidhur brenda 30 ditëve nga data e kësaj deklarate miratimi.

2. MTI-ja pohon se duke nënshkruar këtë dokument, MTI-ja autorizon Bankën të bëjë pagesën e Konsulentit, për të cilën është rënë dakord në Kontratën e Konsulencës, në emër të MTI-së.

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, pala, me anë të përfaqësuesit të saj të autorizuar, ka nënshkruar këtë kontratë, më ….. [data].

PËR DHE NË EMËR TË
Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

LIGJ
Nr. 64/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR (SIDA), NËN FONDIN SUEDEZ TË BESIMIT, PËR FONDIN E BESIMIT NR. TF072239, PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE MJEDISORE ME SHQIPËRINË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administrator i fondeve grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin Suedez të Besimit, për Fondin e Besimit nr. TF072239, për projektin e shërbimeve mjedisore me Shqipërinë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9148, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Banka Botërore
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit

1818 H Street N.W.
Uashington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

10 tetor 2014

Shkëlqesisë së Tij, Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Re: Projekti për Shërbimet Mjedisore me Shqipërinë
Nr. TF suedez TF018238

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë nga Shqipëria (Përfituesi), jam

e kënaqur t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në rolin e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA (Donatori) nën Fondin e Besimit Suedez për Projektin e Shërbimeve Mjedisore, Fondi i Besimit nr. TF072239/SIDA, kontributi nr. 53030017), propozon t'i japë Përfituesit një grant në shumën jo më shumë se shtatë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë dollarë amerikanë ($7,960,000) (Granti) sipas afateve kohore dhe kushteve të parashikuara në këtë letër marrëveshjeje (Marrëveshja), e cila përfshin edhe shtojcën bashkëlidhur për të ndihmuar për financimin e projektit të përshkruar në shtojcë (Projekti).

Ky grant jepet nga fondi i besimit i përmendur më sipër, për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatori. Në përputhje me seksionin 3.02 të Kushteve Standarde (siç parashikohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e pagimit të Bankës Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje, janë të kufizuara në shumat e parave që u vihen në dispozicion nga donatori në zërin e fondit të besimit të përmendur më sipër dhe e drejta e përfituesit për të tërhequr të ardhurat nga granti është objekt i disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Me anë të konfirmimit të marrëveshjes së mëposhtme, Përfituesi deklaron se është i autorizuar të hyjë në këtë Marrëveshje dhe të realizojë projektin në përputhje me kushtet e parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni Marrëveshjen nga ana e Përfituesit në lidhje me sa më sipër, duke e nënshkruar dhe vendosur datën në kopjen e kësaj Marrëveshjeje dhe duke ia kthyer Bankës Botërore. Pas marrjes së kopjes, të kundër-firmosur nga Banka Botërore, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka Botërore në përputhje me seksionin IV të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

Me respekt,
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga:_____
Evis Sulko
Menaxhere e Komanduar për Vendin

Rënë dakord:
Republika e Shqipërisë

Nga:_____
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012.

2. Letra e disbursimit e së njëjtës datë me Marrëveshjen, së bashku me Udhëzimet e Disbursimit për Projektet e Bankës Botërore, datë 1 maj 2006.

Granti nr. TF018238

SHTOJCA

Neni 1
Përkufizimet dhe kushtet standarde

1.01 Kushtet Standarde. Kushtet Standarde për Grantet e Dhëna nga Banka Botërore nga Fonde të Ndryshme, datë 15 shkurt 2012 (Kushtet Standarde) janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me germa kapitale, të përdorur në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshje.

a) "Sistemi i informacionit për pyjet në Shqipëri" është kuadri i teknologjisë së informacionit i projektuar për të marrë të dhëna ose informacion për pyjet dhe kullotat, për të lehtësuar analizimin dhe raportimin e menaxhimit të integruar të pyjeve.

b) "AZHBR" është Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural e Përfituesit, e krijuar dhe që funksionon në përputhje me ligjin "Për zhvillimin bujqësor dhe rural", nr. 9817, datë 22 tetor 2007 ose pasuesi ligjor i tij.

c) "Përfituesit" janë individët dhe organizatat e përzgjedhura për të marrë grantin në përputhje me kriteret e përcaktuara në Manualin e Shfrytëzimit të Granteve.

d) "Planet për Menaxhimin Komunal të Pyjeve dhe Kullotave" ose "PMKPK-të" janë një

instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunat, ku parashikohen masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për menaxhimin e tokës së pyjeve dhe të kullotave për të paktën 10 vjet.

e) "Shoqatat Komunale të Përdoruesve të Pyjeve dhe të Kullotave" ose "SHKPPK-të" janë organizatat joqeveritare që përfshijnë anëtarë të komuniteteve që përdorin burime pyjesh dhe kullotash brenda një zone të një njësie rurale të qeverisë vendore.

f) "Planet Komunale të Menaxhimit të Mikrobaseneve" ose PKMM-të janë një instrument menaxhimi i zhvilluar nga komunitetet, ku përshkruhen masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin e pyjeve, kullotave dhe tokës bujqësore për të paktën 10 vjet.

g) "Seksioni i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor në nivel rrethi" janë strukturat e Përfituesit në nivel rrethi, përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

h) "Marrëveshja e Grantit të GEF-it" është marrëveshja që nënshkruhet ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore, e cila luan rolin e Agjencisë Zbatuese të Fondit Global Mjedisor (GEF), që i jep Përfituesit një grant për të ndihmuar për financimin e pjesëve 1/a, 2/a dhe 3 të Projektit, sipas ndryshimeve që mund t'i bëhen kësaj marrëveshjeje herë pas here. Marrëveshja e Grantit të GEF-it përfshin të gjitha shtojcat, tabelat, dhe marrëveshjet që i bashkëlidhen Marrëveshjes së Grantit të GEF-it.

i) "Plan Gjinor Veprimi" është plani i zhvilluar nga Përfituesi, datë 7 nëntor 2013, për të forcuar pjesëmarrjen e grave në të gjitha aktivitetet e projektit dhe që përbën pjesë të sistemit të monitorimit dhe të vlerësimit të Projektit.

j) "Manuali i Shfrytëzimit të Grantit", është manuali i përgatitur dhe i miratuar nga Përfituesi në përputhje me seksionin 1V. B.1/b/i të pjesës së 2-të të Marrëveshjes së Huas të IBRD-së, siç mund të ndryshohet herë pas here pas miratimit paraprak me shkrim të Bankës Botërore.

k) "Marrëveshja e Huas e IBRD-së" është marrëveshja ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore për të ndihmuar në financimin e pjesëve 1/a, 2/c dhe pjesës 4/a të Projektit.

l) "Grup Lokal Veprimi" ose "GLV" është partneriteti ndërmjet subjekteve publike, private dhe të shoqërisë civile në nivel rajonal për të zhvilluar një zone rurale.

m) "Njësi e Qeverisjes Vendore" ose "NjQV" janë komunat ose bashkitë_____.

n) "MM" është Ministria e Mjedisit e Përfituesit ose pasuesja e saj ligjore.

o) "Inventari Kombëtar i Pyjeve" ose "IKP" është regjistri i të dhënave mbi pyjet, të marra nga informacioni i ofruar nga imazhet satelitore, me qëllim krijimin e një vlerësimi kombëtar për mënyrën sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve brenda një periudhe të caktuar.

p) "Kostot Operative" janë kostot me rritje të arsyeshme graduale që dalin nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzime për pajisje, për stafin e MM-së dhe AZHBR-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të Projektit, përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, dietat për nëpunësit civilë, pajisjet (përjashtuar pagat për nëpunësit civilë), orenditë, materialet, dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

q) "Pagesa për Shërbimet e Ujëmbledhësit" është pagesa që u ofrohet individëve ose grupeve në këmbim të përdorimit të qëndrueshëm të ujëmbledhësit.

r) "Manuali i Shfrytëzimit të Projektit" është manuali i përgatitur në përputhje me seksionin I.B.I të pjesës 2 të kësaj Marrëveshje Huaje të IBRD-së, dhe i konfirmuar si i kënaqshëm nga Banka, i miratuar nga Përfituesi, ku përshkruhen dhe përcaktohen procedurat dhe rregullimet institucionale për zbatimin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje Huaje të IBRD-së dhe me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të aktorëve të angazhuar në zbatimin e Projektit.

s) "Drejtoria e Shërbimit Pyjor" është një strukturë e vartësisë së MM-së, përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe me shërbime të shtrira në nivelin e qarqeve, e krijuar dhe në funksionim në përputhje me ligjin "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" nr. 9385, datë 4 maj 2005, ose pasuesi i tij ligjor.

t) "Nëngrante" janë grantet për përfituesit e pranueshëm për të realizuar nënprojekte.

u) "Nënprojekte" janë nënprojektet e përzgjedhura dhe të miratuara nga Përfituesi, të cilat do të financohen nga ky grant, në përputhje

me kriteret dhe procedurat e parashikuara në Manualin e Shfrytëzimit të Projektit.

Neni 2
Ekzekutimi i Projektit

2.01 Objektivi dhe përshkrimi i Projektit. Objektivi i këtij Projekti është të mbështesë praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe të rrisë përfitimet monetare dhe jomonetare të komuniteteve, në zona të caktuara të zbatimit të Projektit, që kryesisht shtrihen në zona të ngritura rurale të prekshme nga erozioni.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Përmirësimin e Shërbimeve Mjedisore nga Menaxhimi i Integruar i Peizazhit

a) Forcimi i kapaciteteve të Përfituesit për menaxhimin e pyjeve dhe të kullotave, duke përfshirë:

i) përgatitjen e një Inventari Kombëtar të Pyjeve për të zbuluar ndryshimet dhe për të dhënë informacion sesi ka ndryshuar mbulimi me pyje dhe volumi i pyjeve, për periudhën e ndërhyrjes për të cilën do të bihet dakord;

ii) zhvillimin e një Inventari Kombëtar të Pyjeve të shtrirë në dhjetë vjet, nëpërmjet të cilit parcelat e kampionuara për mbulim nga pyjet dhe volumi pyjor shqyrtohen çdo vit për dhjetë vjet;

iii) mbështetjen e planifikimit të menaxhimit të pyjeve, në pyjet prodhuese të menaxhuara nga shteti, duke përjashtuar zonat e mbrojtura;

iv) krijimin e Sistemit shqiptar të Informimit për Pyjet;

v) forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Pyjor për të realizuar detyrimet e saj, duke përfshirë monitorimin e pavarur të pyjeve; dhe

vi) regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që u janë transferuar komunave nga qeveria qendrore.

b) Realizimi i aktiviteteve për të fuqizuar përfituesit, duke përfshirë Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV), Shoqatat Komunale të Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave (SHKPPK) dhe fermerët, për të përdorur praktika menaxhimi të qëndrueshme të tokës dhe të kullotave, duke përfshirë:

i) zbatimin e Planit Gjinor të Veprimit për të nxitur barazinë gjinore në menaxhimin e burimeve natyrore;

ii) mbështetjen e Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) për të kontribuar për strategjinë e zhvillimit;

iii) trajnimin e NJQV-ve dhe SHKPPK-ve për përdorim të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe tokave bujqësore; dhe

iv) nxitjen e gjenerimit të të ardhurave rurale nëpërmjet analizave të zinxhirit të vlerave, përgatitjes së planeve përpunuese dhe tregtimit të produkteve pyjore afatshkurtra dhe afatmesme.

Pjesa 2: Planifikimi dhe Ofrimi i Nëngranteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Tokës

a) Realizimi i aktiviteteve për të përgatitur dhe për të zbatuar Planet Komunale për Mikrobasenet (PKM) për përmirësimin e menaxhimit të tokës, duke përfshirë:

i) hartimin e udhëzimeve për përgatitjen e PKM-ve për nxitjen e përdorimit të integruar të burimeve natyrore;

ii) përgatitjen e PKM-ve për komunat e reja; dhe

iii) përditësimin e Planeve ekzistuese të NJQV-ve të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave (PKMPK), të cilat do të transformohen në KPM gjatë kohëzgjatjes së Projektit.

b) Dhënien e nëngranteve për Përfituesit që i plotësojnë kriteret për realizimin e nënprojekteve.

c) Forcimi i kapaciteteve të stafit të drejtorive rajonale të shërbimit të pyjeve, seksionit të drejtorisë së pyjeve në rreth, AZHBR-së dhe organeve të tjera të përfshira në shërbime bujqësore dhe zgjerimit të pyjeve, si dhe i aplikuesve, të cilët do të përmbushin përgjegjësitë e tyre bazuar në këtë Projekt.

Pjesa 3: Prezantimi i pagesave për shërbimet mjedisore

Krijimi i mekanizmave financues për uljen e degradimit të tokës dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë:

a) përgatitjen e studimeve teknike për zhvillimin e projekteve të karbonit dhe krijimin e sistemeve të monitorimit, raportimit dhe verifikimit, për të përcaktuar masën e karbonit të sekuestruar nëpërmjet aktiviteteve të Projektit;

b) zhvillimin e mekanizmave për pagimin e shërbimeve të ujëmbledhësit, për t'u siguruar se ata që përfitojnë nga shërbimet mjedisore i paguajnë prodhuesit e këtyre shërbimeve; dhe zhvillimin e një modeli për lidhjen e praktikave të përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemit; dhe

c) pilotimin e mekanizmit për pagimin e

shërbimeve të ujëmbledhësit në zonat e përzgjedhura.

Pjesa 4: Mbështetja për zbatimin e Projektit

a) Nëpërmjet realizimit të aktiviteteve për zbatimin e Projektit, duke përfshirë furnizimin me pajisje zyre, ndërtimin e kapaciteteve të stafit dhe zbatimin e garancive mjedisore;

b) Ofrimit dhe instalimit të sistemit të informacionit për monitorimin e Projektit për promovimin e gjurmimit efektiv të aktiviteteve të projektit dhe realizimin e sondazheve, auditeve mjedisore, monitorimit dhe vlerësimit.

2.02 Ekzekutimi i projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të përgjithshëm të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi e realizon Projektin në përputhje me dispozitat e: a) Nenit II të Kushteve Standarde; b) "Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-së", datë 15 tetor 2006, të rishikuara në janar 2011 (Udhëzimet Antikorrupsion); dhe c) nenit II.

2.03 Organizimet institucionale dhe të tjera. Përfituesi e kryen Projektin në përputhje me Manualin e Shfrytëzimit të Projektit dhe nuk ndryshon, pezullon, shfuqizon ose anulon apo heq ndonjë pjesë të Manualit të Shfrytëzimit të Projektit pa miratimin paraprak të Bankës Botërore.

2.04 Vizibiliteti dhe vizitat e donatorit. a) Përfituesi ndërmerr ose ofron marrjen e të gjitha masave që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Banka Botërore për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për Projektin.

b) Për qëllime të seksionit 2.09 të Kushteve Standarde, Përfituesi, me kërkesë të Bankës Botërore, merr të gjitha masat e nevojshme për t'u lejuar përfaqësuesve të donatorit të vizitojnë pjesë të caktuara të territorit të Përfituesit për qëllime të lidhura me Projektin.

2.05 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit. a) Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranuar nga Banka. Çdo Raport Projekti mbulon një periudhë semestri kalendarik dhe i jepet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Përfituesi përgatit Raportin Përfundimtar në përputhje me dispozitën 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti Përfundimtar i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Përfundimit. Për t'u ndihmuar gjatë përgatitjes së Raportit Përfundimtar, Përfituesi kontrakton konsulentë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të pranueshme për Bankën, në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje.

2.06 Menaxhimi financiar. a) Përfituesi garanton mbajtjen e një sistemi financiar menaxhimi në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

b) Përfituesi garanton përgatitjen dhe dorëzimin në Bankën Botërore të raporteve të përkohshme financiare të paauditуara për Projektin jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik, pas përfundimit të çdo kalendari tremujor, në një formë dhe mënyrë që është e pranueshme për Bankën.

c) Përfituesi i auditon pasqyrat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07/b të Kushteve Standarde. Çdo auditim i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.07. Prokurimi

1. a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin, të cilat financohen nga shuma e Grantit, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura, në:

i) Seksionin I të Udhëzimeve të Përgjithshme për Prokurime të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente për Huat e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s, për Huamarrësit e Bankës Botërore, të lëshuara në janar 2011 (Udhëzimet e Prokurimit), në rast të mallrave, punimeve ose shërbimeve jokonsulente.

ii) Seksionin I dhe IV të Udhëzimeve për Përzgjedhjen e Punësimin e Konsulentëve për Huat e IBRD-së, si dhe Kreditë dhe Grantet nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të lëshuara në janar 2011 (Udhëzimet e Prokurimeve), në rast të shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii) Dispozitat e këtij seksioni, pasi ky të përpunohet në planin e prokurimit dhe të përditësohet herë pas here nga Përfituesi i Projektit

në përputhje me paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit (Plani i Prokurimeve).

b) Përkufizimet. Termat e shkruar me germa kapitale, të përdorur në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metoda të rishikimit të kontratave të caktuara nga Banka, i referohen metodës së përshkruar në seksionin II, III, IV dhe V të Udhëzimeve të Konsulentit, sipas rastit.

c) Metoda të Veçanta të Prokurimit të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente:

i) Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin "ii" më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar (THN).

ii) Për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për kontratat e specifikuara në Planin e Prokurimeve, të ndryshme nga Tenderët e Hapur Ndërkombë-tarë, mund të përdoren dhe metodat e mëposhtme: A) Tender i Hapur Kombëtar, objekt i dispozitave shtesë të parashikuara në paragrafin "iii" të këtij seksioni; B) Blerja; dhe C) Kontraktimi i drejtpërdrejtë.

iii) Modifikimet e Procedurave të Tenderëve të Hapur Kombëtarë Konkurrues të Përfituesit. Procedurat e Tenderëve Kombëtarë Konkurrues bazohen në procedurat e Tenderëve të Hapur, siç përcaktohet në ligjin e prokurimeve publike (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), megjithatë, me kusht që kjo procedurë të jetë objekt i dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e "Tenderit të Hapur", siç përcaktohen në LPP-në e Shqipërisë, zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga tenderimi dhe nuk ka preferencë të asnjë lloji për ofertuesit kombëtarë në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri lejohen të japin ofertën e tyre vetëm nëse janë ligjërisht dhe financiarisht autonome dhe funksionojnë sipas ligjit tregtar të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi nuk përdoret si kriter kualifikues për ofertuesit;

c) Ofertat hapen në publik, në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, në praninë e përfaqësuesve që dëshirojnë të marrin pjesë;

d) Autoritetet prokuruese përdorin dokumente tip tenderimi, siç miratohet nga Banka Botërore;

e) Në rastin e ofertave me çmime më të larta krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk skualifikohet pa miratimin paraprak të Bankës;

f) Për dorëzimin e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm;

g) Postkualifikimi realizohet vetëm me ofertuesin më të ulët; në kohën e hapjes së ofertave nuk kundërshtohet asnjë ofertë për shkak të kualifikimeve;

h) Ofertuesit në formën e një shoqërie aksionare, kanë përgjegjësi ligjore të përbashkët dhe individuale;

i) Para skualifikimit të të gjitha ofertave dhe para pranimit të ofertave të reja, merret miratimi paraprak i Bankës Botërore;

j) Kontratat i jepen ofertuesit të vlerësuar me nivel më të ulët, i cili është mjaftueshëm përgjegjës dhe që përcaktohet se është i kualifikuar për të kryer aktivitetin në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të njoftuara më parë për vlerësimin;

k) Negociatat pas ofertimit me ofertën e vlerësuar si më e ulët ose me ofertues të tjerë, nuk lejohen;

l) Kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më tepër se 18 muaj) përmbajnë kushtet e nevojshme për rregullimin e çmimit;

m) Ofertat dhe garancitë e kontratave bëhen sipas formatit të përfshirë në dokumentet e tenderit. Garancia e tenderit është e vlefshme për 28 (njëzet e tetë) ditë pas vlefshmërisë fillestare të ofertës ose për çdo periudhë zgjatjeje, nëse është e nevojshme. Nuk kryhet asnjë pagesë paraprake pa pasur një garanci të përshtatshme për paradhënie;

n) Dokumentet e tenderimit dhe kontrata, që konsiderohen të pranueshme për Bankën Botërore, përfshijnë dispozitat që deklarojnë politikat e Bankës për të marrë masa kundër firmave ose individëve, të cilët janë identifikuar se janë angazhuar në mashtrim ose korrupsion, siç përkufizohet në Udhëzimet e Prokurimeve; dhe

o) Në përputhje me Udhëzimet e Prokurimeve, çdo dokument tenderues dhe kontratë e financuar me të ardhurat e Financimit, parashikon që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit, nënkontraktuesit, agjentët, stafi, konsulentët, ofruesit e shërbimit ose furnizuesit e tyre, lejojnë Bankën të inspektojnë të gjitha llogaritë, të dhënat

dhe dokumentet e tjera të lidhura me ofrimin e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe auditin e tyre nga audituesit e caktuar nga Banka. Aktet, të cilat synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit dhe të drejtat e auditimit të Bankës, të parashikuara në Udhëzimet e Prokurimeve, përbëjnë praktikë penguese, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimeve.

d) Metodat e Posaçme të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve:

i) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në pikën "ii" më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna, bazuar në përzgjedhjen e bazuar në Cilësi dhe Kosto;

ii) Për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata të përcaktuara në Planin e Prokurimeve, përveç Metodës me Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe në Kosto, mund të përdoren metodat e mëposhtme: A) Përzgjedhje e Bazuar në Cilësi; B) Përzgjedhje sipas një buxheti fiks; C) Përzgjedhje e Bazuar në Koston më të Ulët; D) Përzgjedhje e Bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve; E) Përzgjedhje me një Burim të Vetëm për Shoqëritë e Konsulencës; F) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzimeve të Konsulentit, për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë; dhe G) Procedura me një burim për përzgjedhjen e Konsulentëve Individë.

e) Rishikimi i vendimeve të Prokurimeve nga Banka Botërore. Plani i Prokurimeve përcakton ato kontrata që bëhen objekt i Rishikimit Paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i Rishikimit të Mëpasshëm nga Banka.

Neni 3

Tërheqja e të ardhurave nga Granti

3.01 Shpenzimet e pranueshme. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga Granti, në përputhje me dispozitat e: a) Kushteve Standardeve; b) kësaj pjese; dhe c) udhëzimet e tjera shtesë të Bankës Botërore, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Përfituesit (duke përfshirë "Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet për Projektet", të muajit maj 2006, të rishikuara herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje, në përputhje me këto udhëzime), për financimin e Shpenzimeve të Pranueshme, të dhëna në tabelën e mëposhtme. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Granti (Kategori), ndarjen e shumave të Grantit për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranueshme në secilën Kategori:

Kategoria	**Shuma e pjesës së grantit (e shprehur në euro)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë/takë sat)**
1. Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente, trajnimi, kostot operative nën pjesën 1, 2/a/c, pjesën 3/a/c dhe pjesën 4 të Projektit.	6,142,470	100%
2. Nënprojektet nën pjesën 2/b) të Projektit	1,817,530	100%
SHUMA TOTALE:	**7,960,000**	

3.02. Kushtet e tërheqjes. Pa cenuar dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, tërheqja nuk pranohet:

a) për pagesa të kryera para datës së kundërfirmosjes së kësaj Marrëveshjeje nga Përfituesi; ose

b) nën kategorinë 2 të Projektit, jo nëse ose deri kur Përfituesi: i) të ketë përgatitur ose të ketë dorëzuar një Manual për Shfrytëzimin e Granteve të pranueshëm për Bankën Botërore; dhe ii) ta ketë përshtatur softuerin e ARDA-s për menaxhimin e granteve për përdorim nga projekti në një mënyrë që është e pranueshme për Bankën Botërore.

3.03. Periudha e tërheqjes. Data e përfundimit e përmendur në seksionin 3.06/c të Kushteve Standarde është data 30 qershor 2019.

Neni 4

Hyrja në fuqi

4.01 Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Bankës Botërore t'i paraqiten prova të pranueshme për plotësimin e kushteve të mëposhtme:

a) Përfituesi përgatit dhe miraton një Manual Shfrytëzimi për Projektin, i cili është i pranueshëm për Bankën;

b) Përfituesi rekruton një specialist prokurimesh dhe një specialist për menaxhimin financiar me përvojë dhe sipas termave të referencës, të pranueshëm për Bankën;

c) Marrëveshja nr. TF017364 e Bashkë-financimit me GEF-in autorizohet plotësisht ose ratifikohet nëpërmjet të gjitha veprimeve të nevojshme qeveritare dhe të tjera;

d) Është realizuar Marrëveshja nr. 8401 e Huas së IBRD-së për Projektin e Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri, si dhe të gjitha kushtet që i paraprijnë hyrjes së saj në fuqi ose së drejtës së Përfituesit për të bërë tërheqje sipas Marrëveshjes së Huas së IBRD-së (të ndryshme nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje).

Neni 5

Përfaqësuesi i Përfituesit; adresat

5.01 Përfaqësuesi i Përfituesit. Përfaqësuesi i Përfituesit i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde është Ministri i Financave.

5.02 Adresa e Përfituesit. Adresa e Përfituesit e përmendur në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Ministri i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 42228494

5.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore që përmendet në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Kabllor:
INTBAFRAD
Uashington, D.C.
Teleks:
248423 (MCI) ose
64145 (MCI)
Faks:
1-202-477-6391

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë